

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA”

FAKULTETI JURIDIK

PROGRAMI: JURIDIKO-PENAL

NIVELI: MASTER



UNIVERSITETI • UNIVERSITY
“KADRI ZEKA”

PUNIM DIPLOME

**Veprat penale të korrupsionit në territorin e Gjykatës Themelore të
Gjilanit gjatë periudhës kohore 2018-2023**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Albulena Hajdari Krasniqi

Kandidatja:

Flaviana Halili

Gjilan, 2024

Deklarata etike

Unë, Flaviana Halili, me përgjegjësi të lartë etike dhe morale, deklaroj se ky punim është shkruar nga unë dhe nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë komisioni ose institucioni për vlerësim.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara në brendësi të tij.

Falënderimet

Një falënderim të veçantë për mentoren time Prof.Ass.Dr. Albulena Hajdari Krasniqi, për mbështetjen dhe ndihmën e dhënë gjatë gjithë periudhës së studimeve, si dhe kontributin e saj në finalizimin e punimit të diplomës.

Falënderimi më i madh është për **prindërit e mi dhe partnerin e jetës time** të cilët asnjëherë nuk ndaluan mbështetjen e tyre që unë të arrij sukseset e mia. Jam me fat që jeni pjesë e jetës sime!

ABSTRAKTI

Çështja kryesore e trajtuar në këtë punim është korrupsioni në pergjithësi dhe vepra penale e korrupsionit në Gjilan në periudhën kohore 2018-2023 në veçanti.

Trajtimi i kësaj teme është bërë si rezultat i mungesës së trajtimit të një çështjeje të tillë edhe pse pothuajse çdo ditë dëgjojmë për veprën penale të korrupsionit, mirëpo rastet kur kryerësit e kësaj vepre dënohen janë më të rralla.

Konsideroj se ky punim ka një rëndësi të madhe, sepse në brendësi të tij trajtohet nocioni i korrupsionit, llojet e tij, shkaqet e paraqitjes së tij, pasojat, disa raste të dështimit të shtetit ndaj korrupsionit si dhe do të bëjë një krahasim në mes te veprës penale të korrupsionit në disa shtete si në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut në raport me Republikën e Kosovës.

Ky punim paraqet një pasqyrë të saktë të veprave penale të korrupsionit të cilat kanë qenë të evidentuara në Gjykatën Themelore në Gjilan për periudhën kohore 2018-2023 si dhe llojet e sanksioneve penale të cilat janë shqiptuar për kryerësit e këtyre veprave penale.

Statistikat janë mbledhur në Gjykatën Themelore të Gjilanit nga librat amë të kësaj gjykate.

Për këtë punim është shfrytëzuar literaturë akademike, Kodet e shteteve të përmendura më lartë, ligje, raporte të publikuara online etj.

Korrupsioni si fenomen negativ ka ekzistuar në një formë ose në një tjetër për një kohë të gjatë në historinë njerëzore, megjithatë në kohën që jetojmë me një zhvillim të madh të teknologjisë dhe rritjen e lidhjeve ndërkombëtare është bërë pak më e vështirë lufta kundër tij.

Ai paraqet një sfidë të madhe të institucioneve dhe shoqërisë në Kosovë sepse është një ndër pengesat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, politik dhe social të vendit tonë.

Nga rezultatet modeste të këtij punimi mund të arrihet në përfundim se ka nevojë të zhvillohet dhe zbatohet një politikë për parandalimin e korrupsionit nga ana e institucioneve sepse si dukuri është shumë e përhapur mirëpo rastet e sanksionimit të kësaj vepre penale janë të vogla dhe zakonisht përfundojnë vetëm me dënim me gjobë.

Fjalë kyçe: korrupsioni, parandalimi, gjykata, sanksioni, vepër penale

Shkurtesat

BE – Bashkimi European;

KPRK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës;

KPPK – Kodi i Procedurës Penale të Kosovës ;

KPRSH – Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ;

KPRM – Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë ;

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës;

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës ;

PSRK - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës;

Lista e tabelave

Tabela 1. Veprat penale të korrupsionit në Gjykatën Themelore në Gjiilan	51
Figura 1. Llojet e sanksioneve penale të shqiptuara	52
Figura 2. Vlera e dënimeve me gjobë	52

Përmbajtja

Abstrakt.....	4
Lista e shkurtesave	5
Lista e tabelave	6
KAPITULLI I	9
1. HYRJE	9
1.1 Qëllimi i punimit	10
1.2 Objektivat e punimit	10
1.3 Hipotezat	10
1.4 Pyetjet hulumtuese	10
1.5 Metodologjia e punimit	11
KAPITULLI II	12
2. VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME PËR KORRUPSIONIN	
2.1 Përkufizim i përgjithshëm mbi korrupsionin	12
2.2 Përkufizimi juridik i korrupsionit	14
2.3 Historiku i korrupsionit	15
2.4 Karakteristikat dhe llojet e korrupsionit	16
2.5 Personat fizik si kryerës të veprës penale të korrupsionit dhe përgjegjësia penale e tyre...	18
2.6 Personat juridikë si kryerës të veprës penale të korrupsionit dhe përgjegjësia e tyre	23
2.7 Sfidat në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë	24
KAPITULLI III	28
3. VËSHTRIM KRAHASUES I KORRUPSIONIT	
3.1 Korrupsioni sipas legjislacionit penal të Republikës së Kosovës	28
3.2 Korrupsioni sipas legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë	34
3.3 Korrupsioni sipas legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut	38

KAPITULLI IV	42
4. FENOMENOLOGJIA DHE ETIOLOGJIA E KORRUPSIONIT	
4.1. Kuptimi i fenomenologjisë dhe format e paraqitjes së korrupsionit	42
4.2 Faktorët e paraqitjes së korrupsionit	44
4.3 Pasojat e korrupsionit	45
4.4 Zbulimi dhe hetimi i korrupsionit	46
4.5 Parashkrimi i veprave penale të korrupsionit	47
 KAPITULLI V	
5. KORRUPSIONI NË GJILAN GJATE PERIUDHËS 2018-2023	49
PËRFUNDIMET	53
REKOMANDIMET	54
BIBLIOGRAFIA	56

KAPITULLI I

1.HYRJE

Një fakt shqetësues është perceptimi i qytetarëve për korrupsionin. Shfaqja e praktikave korruptive në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe veprimtarisë shtetërore, bën që korrupsioni prej qytetarëve të konsiderohet si si një fenomen normal. Ai konsiderohet thjesht një mjet që mundëson zgjidhjen e shpejtë të problemeve të tyre, duke mos e perceptuar faktin se janë përfshirë edhe vetë në një akt korruptues.

Korrupsioni ekziston, prej që ekziston njerëzimi në të gjitha mjediset dhe në të gjitha sistemet e mundshme. Ai është përshtatur me të gjitha situatat dhe mbijeton edhe gjatë fushatave më të organizuara kundër tij. Nënkupton secilën shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si një përgjigje ndaj një shpërblimi që në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthore është ofruar, kërkuar, premtuar, pranuar apo është pritur për t'u marrë për veten ose për një person tjetër.

Kjo dukuri shfaqet në shumë forma të ndryshme, duke përfshirë shpërdorimin e pushtetit publik, vjedhjen e burimeve publike, manipulimin e proceseve politike dhe gjyqësor, sjelljen e pamoralshme në fushat e biznesit dhe të financave etj.

Në Kosovë e ka prekur shoqërinë tonë në tërësi duke filluar nga institucionet e larta duke përfshirë pushtetin legjislativ, ekzekutiv si dhe atë gjyqësor por jo vetëm këto por edhe njeriun e thjeshtë duke dhënë rezultat një shoqëri kriminale.

Vepra penale e korrupsionit është e shfaqur edhe në rajonin e Gjilanit në forma të ndryshme dhe përmes këtij punimi do të hulumtohen disa raste të caktuara.

Realizimi i këtij punimi është i ndarë në kapituj, gjithsej janë 6 kapituj.

Në Kapitullin e parë: Përfshihet hyrja, qëllimi i realizimit të këtij punimi, objektivat, pyetjet hulumtuese, hipotezat si dhe metodologjia e përdorur.

Në Kapitullin e dytë: Përkufizohet korrupsioni në aspektin e përgjithshëm pastaj atë juridik, historiku i tij, llojet e tij si dhe përgjegjësia e personave fizikë dhe juridik.

Në Kapitullin e tretë: Trajtohet korrupsioni në aspektin krahasues duke e bërë një krahasim në mes të korrupsionit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut.

Në Kapitullin e katërt: Trajtohen format dhe shkaqet e paraqitjes së korrupsionit, pasojat e tij, parashkrimi i veprave penale të korrupsionit si dhe do të shikohen disa raste ku shteti ka dështuar ta luftojë korrupsionin.

Në Kapitullin e pestë: Trajtohet vepra penale e korrupsionit në Gjykatën Themelore në Gjilan në periudhën kohore 2018-2023 në bazë të të dhënave të marra nga librat amë të kësaj gjykate.

Si dhe në nënkapituj do të jepen përfundimet dhe rekomandimet e nxjerrura nga ky punim.

1.1 Qëllimi i punimit

Ekzistojnë disa faktorë dhe rrethana që më kanë shtyrë për të trajtuar këtë temë. Fillimisht vepra penale e korrupsionit është mjaft e përhapur në Kosovë mirëpo rastet e dënimit të këtyre veprave janë mjaft të vogla dhe edhe nëse dënohen zakonisht dënohen me dënime minimale ose denim me gjobë. Besohet se korrupsioni është fenomen shumë i përhapur por ka mungese të hulumtimeve lidhur me të.

Marrë parasysh dëmet e mëdha që shkakton korrupsioni në shoqërinë, duke përfshirë dobësimin e besimit në institucionet publike, rritjen e pasigurisë juridike dhe ndikimin negativ në zhvillimin ekonomik dhe social duhet bërë përpjekje që të zhvillohen më shumë mekanizma në luftën kundër tij dhe jo vetëm kaq por duhet punuar edhe në politikat parandaluese sepse pasojat e tij janë të mëdha dhe e prekin pothuajse secilin individ.

Në kuadër të këtij punimi të Masterit, nga rezultatet e hulumtimit të bërë në Gjykatën Themelore në Gjilan për periudhën kohore 2018-2023 do të prezantohen se për sa vepra penale të korrupsionit janë shqiptuar sanksione, çfarë lloje të sanksioneve janë shqiptuar dhe sa persona janë liruar nga akuza për korrupsion.

1.2 Objektivat

- Të përmbledhë informacione lidhur me korrupsionin në përgjithësi;
- Të përmbledhë informacione lidhur me veprën penale të korrupsionit në Gjykatën Themelore në Gjilan;
- Të analizojë nevojën e plotësimit të legjislacionit ;
- Të analizojë rrezikun që vjen nga mos luftimi i korrupsionit.

1.3 Hipotezat

Hipoteza 1: Legjislacioni kosovar i ka mekanizmat për luftën kundër korrupsionit;

Hipoteza 2: Shteti nuk po bën luftë efektive kundër veprës penale të korrupsionit;

Hipoteza 3: Kryerësit e veprave penale të korrupsionit po dënohen me dënime minimale.

1.4 Pyetjet hulumtuese

- Çka është korrupsioni?
- Cilat janë llojet e korrupsionit?
- Cila është përgjegjësia penale e kryerësve të veprave penale të korrupsionit?
- Cilat janë format e paraqitjes së veprave penale të korrupsionit?
- Cilat vepra penale të korrupsionit janë kryer në Gjilan në periudhën kohore 2018-2023?
- Cilat janë efektet e korrupsionit?

1.5 Metodologjia

Për të sjellë përgjigje mbi pyetjet hulumtuese dhe hipotezat e ngritura duhet të bëjmë një kombinim në mes të metodave. Për përgaditjen e këtij punimi kam përdorur këto metoda:

Metodën historike: Domosdoshmërisht gjatë kërkimit dhe hulumtimit shkencor të një fenomeni duhet ti kushtojmë rëndësi metodës historike në mes së cilës shqyrtohet dhe pasqyrohet ekzistenca dhe evoluimi i korrupsionit dhe mënyrat e paraqitjes së tij.

Metodën e analizës teorike: Duke analizuar korruptionin si vepër penale me format dhe tiparet e tij

Metodën përshkruese: Me qëllim të dhënies së përkufizimit juridik të korrupsionit sipas legjislacioneve ndërkombëtare.

Metodën krahasuese: Duke bërë krahasim të legjislacionit kosovar me atë të vendeve të tjera si të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

KAPITULLI II

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME PËR KORRUPSIONIN

2.1 Përkufizim i përgjithshëm mbi korrupsionin

Korrupsioni paraqet një fenomen kompleks për shkak se përfshin disa aspekte nga etika apo morali, ndryshimet kulturore dhe deri tek aspekti ligjor. Luan Gjonçaj e përcakton atë “si dukuri të ndërlikuar sociale e në radhë të parë botëkuptimore, e cila shfaqet në të gjitha sferat e jetës shoqërore-shtetërore”.¹ Në korrupsionin mplekset e drejta me moralin, qeverisja me burokracinë, lufta për ekzistencë me veprimtaritë kriminale me qëllim përfitimin pasuror, dëshirat e popujve për rinde demokratike me krimin e shkeljen e ligjit. Ai vazhdon të mbetet një fushë ku ende mund të eksplorohet për shkak të mungesës së përcaktimit plotësisht të pranuar por edhe për shkak se identifikimi i përmasave reale të korrupsionit mbetet një detyrë e vështirë ndërkohë që një nga karakteristikat e korrupsionit është fshehtësia.²

Në përgjithësi përdorimi i fjalës “*korruption*” lidhet me terma të tillë si “*mitë*” ose “*ryshfet*”, por në realitet korrupsioni shkon përtej marrjes dhe pagesës së një ryshfeti, i cili përbën vetëm një pjesë të fenomenit të gjerë të korrupsionit. Debatet nëse korrupsioni përfaqëson një mëkat ose një vepër penale janë aktuale edhe pse i kanë filltet në teoritë klasike të teorisë politike.³

Në fjalorin e gjuhës shqipe gjenden një zhargon fjalësh që e përkufizojnë atë të cilat janë: ryshfete, vjedh, shkatërroj shkel ligjin, shtyj dikë nëpërmjet një dhurate që të veprojë kundër detyrës që ka, veprime jo morale etj.,. Pra, siç shihet, korrupsioni është një koncept shumë i gjerë.

Në kuptim më të përgjithshëm, korrupsioni paraqet shpërdorim të pushtetit nga ana e nëpunësit shtetëror për përvetësimin e paligjshëm të pasurisë për veten apo personin fizik ose juridik. Shumica e autorëve korrupsionin e cilësojnë si një keqpërdorim të kompetencave të tyre publike, pushtetit politik dhe ekonomik, për të përvetësuar në mënyre ilegale përfitime pasurore ose jo pasurore, si për veten ashtu dhe për personin tjetër.⁴

Me korrupsion duhet kuptuar format e ndryshme të veprimeve kriminale të cilat konsistojnë në kërkimin për dhënien e mitos, marrjen e mitos, ryshfetin indirekt, trafikimin e influencës, pagesën

¹ Gjonçaj, L. Korrupsioni (Veprat penale përbërëse, krimi i organizuar), Tiranë, 2004, fq. 194.

² Po aty, fq. 195.

³ Po aty, fq. 198.

⁴ Teofilovic, N & Jelacic, M Beograd, Prevention, Detection and Proving corruption-related criminal acts and money laundering, 2006 ,fq.10.

ilegale ose kërkimin e dhuratave të paligjshme, pagesën e tarifave të cilat janë në disproporcion me shërbimet e kryera, pastrimi i parave etj, me qëllim që të bëhet përfitim material i paligjshëm.⁵

Shkencëtari politik Xhozef Nai, e përkufizon korrupsionin si “sjellje që devijon nga detyrat normale të rolit publik, që favorizon ata që janë pjesëtarë të familjes, anëtarët e një klike të mbyllur private, dhe që kërkon përfitime në para ose status që dhunojnë rregullat kundër ushtrimit të disa llojeve të caktuara të influencës personale”. Këtu përfshihen sjellje të tilla si ryshfeti, përvetësimi dhe nepotizmi.⁶

Sipas Transparency International, korrupsioni qëndron në abuzimin e pushtetit të fituar përmes delegimit për qëllim privat. Ky përkufizim vë në dukje tre elementë përbërës të korrupsionit:

1). Abuzimin e pushtetit, 2). Pushtet i fituar nga delegimi, që do të thotë se mundet të burojë si prej sektorit publik ashtu edhe prej sektorit privat, 3).Qëllim privat, që do të thotë se nuk përfiton vetëm abuzuesi i pushtetit, por përfshihen gjithashtu anëtarët e afërt të familjes ose miqtë e tij. Transparency International përdor ndonjëherë edhe këtë përkufizim: “*abuzim i pushtetit me qëllim të pasurimit personal*.”⁷

Për Komisionin European, korrupsioni është i lidhur me secilin abuzim të pushtetit dhe secilën parregullsi të kryer në proces të vendimarrjes, në shkëmbim të një nxitje apo një avantazhi të padrejtë”. Korrupsioni është një ndër krimet e rënda, i cili shfaqet me një dimension ndërkufitar. Shpesh ai është i ndërlidhur me forma të tjera të krimeve të rënda siç janë trafikimi me qenie njerëzore, trafikimi i drogës dhe se ky fenomen nuk mund të trajtohet në mënyrë të duhur vetëm nga shtetet e BE-së.⁸

⁵ Hajdari, A. “Veprat Penale me natyrë korrupsioni me një vështrim të posaçëm në Kosovë”, Prishtinë, 2003, fq.49.

⁶Duk V. Trang, “Korrupsion dhe Demokraci”, Tiranë, 1994, fq.16.

⁷Artikull i Transparency International, i qasshëm në: https://www.transparency.org/en/cpi/2023?gad_source=1&gclid=EAIaIQobChMI2Ojxs9XfhQMV9WWRBR2ZlQxEAAYASAAEgLDW_D_BwE , shfletuar më 07.05.2024.

⁸ Artikull i Komisionit European, i qasshëm në: https://home-affairs.ec.europa.eu/policies/internal-security/corruption_en , shfletuar më 09.05.2024.

2.2 Përkufizimi juridik

Korrupsioni është parashikuar jo vetëm me ligje mirëpo edhe në nivel kushtetues. Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e sanksionon në mënyrë korrupsionin duke e vlerësuar akuzën për korrupsion të mjaftueshme për shkarkimin e presidentit, zëvendës presidentit si dhe nëpunësve civilë të SHBA-ve.⁹

Konventat e ndryshme mbi korrupsionin përfaqësojnë instrumente të rëndësishme ligjore, sepse për to ekziston konsensus i përgjithshëm, i cili shprehet nëpërmjet ratifikimit nga shtetet përkatëse, por edhe sepse për zbatimin efektiv të tyre kërkohet plotësimi apo harmonizimi i legjisllacionit të brendshëm me aktet ndërkombëtare. Përcaktime të ndryshme mbi korrupsionin e vënë theksin mbi elementë të ndryshëm të tij, pasi për disa studiues korrupsioni lidhet me mungesën e barazisë, pabarazinë në realizimin e të drejtave subjektive, në të ardhura si dhe para ligjit.

Debatet mbi përcaktimin e korrupsionit vazhdojnë ende, e të cilat janë rritur ndjeshëm në teoritë bashkëkohore, ku termi korrupsion përfaqëson ndoshta problemin më të larmishëm dhe kompleks, për shkak të figurave të ndryshme të veprave penale të korrupsionit, për shkak të formave se si ai shfaqet, diskrecionit dhe vështirësisë për t'u zbuluar, marrëdhënies së pretenduar të përfitimit reciprok si një marrëdhënie këmbimi midis subjekteve aktivë dhe pasivë të korrupsionit. Qasjet bashkëkohore mbi korrupsionit e trajtojnë atë si një krim kundër njerëzimit.

Veprave penale të korrupsionit, shpesh i referohemi me termin “krim i jakave të bardha”. Term ky i cili është përdorur për herë të parë në vitin 1939 gjatë një fjalimi në Shoqërinë e Sociologëve Amerikanë nga Edvin Sutherland ku sipas kuptimit të atëhershëm i referohet një krimi që është kryer nga persona të respektueshëm, me status të lartë në shoqëri.¹⁰

Sutherland evidentoi pesë elementë thelbësorë të krimit ekonomik: 1) ekzistenca e një krimi; 2) që kryhet nga një person i respektueshëm; 3) me një pozitë të ngritur shoqëror; 4) që ka lidhje me pozicionin e tij; 5) duke shpërdorur besimin. Pavarësisht shumë debateve që gjeneron ky term sot “white collar crime” i referohet krimeve jo të dhunshme që janë kryer në situata këmbimi për përfitime materiale. Ky lloj kriminaliteti paraqet vështirësi në zbulim dhe hetim për shkak të mjeteve të sofistikuar që përdoren si dhe transaksioneve komplekse, që kryhen për fshehjen e tij deri tek pastrimi i parave.¹¹

Sipas Ligjit Nr.2004/34 kundër korrupsionit, i cili ka qenë më herët në fuqi në Kosovë me korrupsion është nënkuptuar çdo shkelje e detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shpërblimi

⁹Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e qasshme në: https://www.senate.gov/about/origins-foundations/senate-and-constitution/constitution.htm#a4_sec1, shfletuar më 09.04.2024.

¹⁰ Halili, R. Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq. 138.

¹¹ Po aty, fq. 139.

që drejtpërdrejt ose indirekt është ofruar, kërkuar, premtuar, dhënë, pranuar apo është pritur për t'u marrë për veten ose për një person tjetër.¹²

2.3 Historiku i korrupsionit

Korrupsioni është një dukuri aq e vjetër sa edhe vetë historia e zhvillimit njerëzor. Në të kaluarën e largët format dhe mënyrat e korrupsionit kanë qenë të ndryshme krahasuar me të këto që janë sot, por thelbi ka qenë është dhe do të jetë i njëjtë domethënë, shkatërrimi i gjithçkaje të përparuar dhe morale. Atë e gjen në të gjitha mjediset, në të gjitha sistemet dhe regjimet e mundshme duke u përshtatur me të gjitha situatat dhe duke mbijetuar edhe gjatë fushatave më të organizuara kundër tij.

Korrupsioni përkufizohet nga Fjalorët e Oksfordit si "*sjellje e pandershme ose mashtruese nga ata që janë në pushtet, që zakonisht përfshin ryshfetin*".¹³

Korrupsioni mbeti një fenomen i përhapur dhe i përsëritur gjatë gjithë historisë njerëzore. Ai ka qenë i pranishëm në të gjitha sistemet politiko-shoqërore, në nivele si dhe forma të ndryshme. Kodi i Hammurabit i shekullit XVIII p.e.r. kishte masa ndëshkimore të bazuara ligjërisht kundër punëtorëve të korruptuar dhe veçanërisht parasheh korrupsionin e gjyqtarëve. Gjithashtu edhe mendimtarë dhe filozofë të njohur si Platoni, Makiavelli, Aristoteli, dhe Rusoi, kanë studiuar korrupsionin qeveritar.¹⁴

Në Ligjet e Perandorisë Romake kishte një formulim për përcaktimin e korrupsionit (ryshfetit) që shprehte opinionin negativ publik romak dhe mendimet politiko-kriminale të asaj kohe. Në fjalimet e Ciceronit shpeshherë trajtoheshin problemet që lidheshin me marrjen dhe dhënien e ryshfetit nga nëpunësit e shtetit.¹⁵

Në jetën politike të Romës së lashtë, korrupsioni kishte arritur tashmë një nivel të konsiderueshëm deri në atë kohë. Jul Cezari ishte i famshëm për përdorimin e çdo mjeti, përfshirë dhunën dhe paratë, për të marrë konsullatën, për të eliminuar Senatin dhe për të gjetur një Romë të re.¹⁶

¹² Ligji Nr.2004/34 kundër korrupsionit, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2441> , shfletuar më 09.03.2024.

¹³Fjalor i Oxford-it, i qasshëm në: <https://www.oed.com/search/dictionary/?scope=Entries&q=corruption>, shfletuar më 10.04.2024.

¹⁴ Shera, A. Korrupsioni dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike, Tiranë, 2014, fq. 2-3.

¹⁵ Latifi, V. Kriminalistika, Prishtinë, 2011, fq. 276.

¹⁶ "Corruption new insights" edited by Josiane Fahed-Sreih, fq. 9.

2.4 Karakteristikat dhe llojet e korrupsionit

Korrupsioni shfaqet në të gjitha sistemet shoqërore dhe të gjitha shtetet pa marrë parasysh zhvillimin e tyre shoqëror dhe varësisht se ku shfaqet ka edhe karakteristikat e veta.

Në përgjithësi si karakteristika kryesore janë:¹⁷

Fshehtësia, ku shumica e veprave penale të korrupsionit kryhen në mënyrë të fshehtë për të shmangur zbulimin dhe ndjekjen penale.

Shfrytëzimi i pushtetit, sepse vepra penale e korrupsionit kryhet zakonisht kur qytetarët shfrytëzojnë pozitën e tyre të fuqishme në institucione publike për të përfituar në mënyrë të paligjshme.

Motivi financiar, i cili është një ndër motivet kryesore për veprën penale të korrupsionit, ku individët përdorin pushtetin e tyre për të përfituar në mënyrë të paligjshme nëpërmjet ryshfetit, shantazhit apo abuzimit me fonde publike.

Pasi që për korrupsionin ka përkufizime të ndryshme dhe për shkak që nuk ka ndonjë përkufizim të pranuar në aspekt ndërkombëtar, nuk ka ndonjë tipologji universale të vlefshme të korrupsionit.

Më së shumti flitet për korrupsionin politik, ekonomik dhe atë në administratën publike, përpos kësaj ndarje shumë autorë e bëjnë ndarjen në korrupsion aktiv dhe pasiv.

a) *Korrupsioni politik*

Në përkufizimin e ndarë nga shumica e shkencëtarëve politikë, korrupsioni politik është çdo transaksion ndërmjet aktorëve të sektorit publik dhe privat nëpërmjet të cilit të mirat kolektive janë konvertuar në mënyrë të paligjshme për përfitime private në lidhje me përfitimet.¹⁸

Korrupsioni politik jo vetëm që dërgon në shpërndarjen e gabuar të burimeve, por edhe ndikon në mënyrën e marrjes së vendimeve. Korrupsioni politik paraqet manipulimin e institucioneve politike dhe rregullores, andaj edhe influencon institucionet e qeverisjes dhe sistemin politik dhe shpesh çon në prishje institucionale.

Pra, korrupsioni politik është diçka më shumë se vetëm devijim nga normat juridike formale dhe të shkruara, nga kodet e etikës profesionale dhe vendimet e gjykatave. Korrupsioni politik është kur ligjet dhe rregulloret janë abuzuar sistematikisht, anashkaluar, injoruar ose iu janë përshtatur dëshirave të pushtetarëve.¹⁹

¹⁷ Duk V. Trang, “Korrupsion dhe Demokraci”, Tiranë, 1994, fq.19.

¹⁸ Heidenheimer, R, Arnold J, Michael Johnston, & Victor T. LeVine, Corruption, Capitalism and Democracy. London, 1997, fq. 24.

¹⁹ Po aty, fq. 31.

Siç u theksua kuadri ligjor formal i shtetit është i pamjaftueshëm përse i përket kushteve të referencës për të vlerësuar dhe gjykuar problemin e korrupsionit politik.

Korrupsioni politik është ajo formë e korrupsionit që sjellë deri tek ndryshimi i dispozitave, respektivisht deri tek ndryshimi i ligjit në pajtim me interesa private të korruptuesit.²⁰

Korrupsioni politik ka të bëjë me marrjen dhe mbajtjen e pushtetit dhe privilegjeve të caktuara politike, nga pozicioni lokal e deri tek ai qendror. Korrupsioni politik duhet kërkuar në lidhshmëri të një elite politike më bartësit e fuqishëm ekonomikë të cilët njëherë janë edhe financuesit e partive politike dhe subjekteve të tjera të shtetit.

Korrupsioni burokratik normalisht mund të trajtohet me anë të auditimit, legjislacionit dhe rregullimeve institucionale. Korrupsioni politik kërkon reforma radikale politike sepse efektet e korrupsionit politik nuk mund të kundërshtohen vetëm në qasje administrative.

Këtu korrupsioni është një sëmundje që politikanët janë të etur për ta shmangur, kjo është një praktikë e qëllimshme, e kërkuar dhe e aplikuar sepse paraqet një nga mënyrat e pasurimit dhe kontrollit ekonomik të pushtetarëve politikë.²¹

b) Korrupsioni ekonomik

Është një formë e korrupsionit që përfshinë shfrytëzimin e institucioneve ekonomike dhe proceseve për përfitime personale ose përfitime të ngushta për një grup të caktuar.²²

Përfshin veprime si favorizim të bizneseve në procesin e prokurimit publik, mashtrimi me tenderë, pagesat nën tavolinë, zbulimin e informacioneve të brendshme për përfitime në treg etj.

Korrupsioni ekonomik mund të ndikojë negativisht në zhvillimin ekonomik, duke ndaluar konkurrencën e drejtë dhe duke e ulur besimin e qytetarëve në institucionet publike dhe private.²³

c) Korrupsioni në administratën publike

Korrupsioni në administratën publike është praktikë e abuzimit të pozitive zyrtare për përfitime personale të personave të caktuar në sektorin publik. Kjo mund të përfshijë marrje të ryshfetit për të dhënë shërbime publike, favorizim të personave, shpërdorim të fondeve publike etj, i cili shkakton mosbesim të qytetarëve në qeverisje dhe dëmton efikasitetin dhe integritetin e shërbimeve publike. Korrupsioni administrativ ka të bëjë me administratën shtetërore, duke i shfrytëzuar kompetencat në administratë, nga ajo lokale tek ajo qendrore. Merr ryshfet domethënë korruptohet duke u dhënë leje, çertifikata, dokumente dhe akte të tjera individëve apo grupeve për

²⁰ AntoniĆ D, Korupcija u Srbiji, Beograd, 2001, fq. 21-23.

²¹ Zurnic, M. Corruption and democratic transition in Eastern Europe, Belgrade, 2019, fq. 156.

²² Gaffney M&Harrison F, The corruption of economics, London, 2023, fq. 24.

²³ Mauro, P. "Corruption and Economic Growth." Quarterly Journal of Economics, 1995, fq. 59.

realizimin e interesave të ndryshme financiare për grumbullimin e pasurisë.²⁴ Ai ndodh në hallkën e fundit të implementimit të politikave, aty ku publiku takohet me nëpunësit publikë. Korrupsioni i vogël shfaqet ndryshe si “*korupsioni i mbijetesës*”, një korrupsion i cili bëhet zakonisht nga punëtorë të cilët nuk paguhen mirë. Edhe pse ky lloj i korrupsionit përfshin shuma më të vogla të parave, këto shuma gjithsesi nuk janë të vogla për ata të cilët i paguajnë. Korrupsioni i vogël sfidon qytetarët që kanë të ardhura të ulëta dhe që duhet të paguajnë pothuajse gjithmone ryshfet në kontaktet e tyre me administratën dhe shërbimet publike.²⁵

2.5 Personat fizik si kryerës të veprës penale të korrupsionit dhe përgjegjësia penale e tyre

Veprat penale të korrupsionit mund të kryhen nga persona të ndryshëm qoftë fizikë ose juridikë.

Personat që kryejnë vepër penale quhen subjekt i veprës penale.

Subjekt të veprës penale të korrupsionit mund të jenë personat fizikë që kanë mbushur moshën 14 vjeçare, sepse personat nën moshën 14 vjeçare konsiderohen fëmijë.²⁶

Nëse merret për bazë pozita e tyre, në të drejtën penale njihen dy lloje të subjekteve të veprave penale, subjekti aktiv dhe subjekti pasiv. Subjekti aktiv i veprës penale konsiderohet personi i cili me veprimin e tij shkakton pasojën e veprës penale²⁷. Në të shumtën e rasteve veprat penale mund t'i kryejë çdo subjekt. Veprat penale të cilat mund t'i kryejë çdo person quhen “*delicta communia*”. Këto janë veprat penale që ligjdhënësi i përcakton me formulimin “Kushdo që kryen ..”, p.sh. vrasjen, lëndimin trupor, vjedhjen, grabitjen etj. Mirëpo, ekzistojnë disa vepra penale të cilat për shkak të tipareve të tyre të veçanta, nuk mund t'i kryejë çdo person, por vetëm një kategori e personave që posedojnë veti ose që gjenden në marrëdhënie të caktuara apo të veçanta. Kështu, p.sh. veprën penale të vrasjes së foshnjës gjatë lindjes mund ta kryejë vetëm nëna; veprën penale të marrjes së ryshfetit mund ta kryejë vetëm personi zyrtar; veprën penale mosdhënia e ndihmës mjekësore mund ta kryejë mjeku ose punonjësi tjetër shëndetësor etj. Veprat penale të tilla, të cilat mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë veti të caktuara apo që gjenden në marrëdhënie të caktuara, quhen “*delicta propria*”. Subjekt pasiv i veprës penale konsiderohet personi që është dëmtuar ose që është rrezikuar me veprën penale. Pra, subjekti pasiv i veprës penale është i dëmtuari apo viktimë e veprës penale. I dëmtuar apo viktimë, konsiderohet personi, të cilit çfarëdo e drejte personale apo pasurore i është dëmtuar apo rrezikuar me vepër penale. I dëmtuar mund të jetë si personi fizik, ashtu edhe personi juridik.²⁸

²⁴ Torsello, D. Corruption in Public Administration, 2016, fq. 84-85.

²⁵ Edward Glaeser, ‘Lessons from America’s Economic History’, 2004, fq. 45.

²⁶ Salihu, I. E drejta penale-pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015, fq. 189.

²⁷ Burim Ademi & Afrim Shala & Avni Mehmeti, ‘Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale)’, i qasshëm në: <http://jus.igjk.rks-gov.net/801/1/Moduli-penale-shqip%20i%20rishikuar%20nga%20autor%C3%ABt%20%28finali%29.docx.pdf>, shfletuar më 10.09.2024

²⁸ Po aty.

Që një person të konsiderohet përgjegjës për veprë penale ai duhet të jetë fajtor dhe të jetë i përgjegjshëm, domethënë përgjegjësia penale përbëhet nga dy elemente: nga vetitë e caktuara psiçike të kryerësit dhe nga qëndrimi apo marrëdhënia e kryerësit ndaj veprës që e ka kryer (nga fajësia).

Personi konsiderohet i përgjegjshëm kur është posedon aftësi psikike që i bëjnë të mundshme të kuptojë rëndësinë e veprës penale dhe t'i kontrollojë veprimet e veta, ndërsa konsiderohet i fajshëm atëherë kur ndaj veprës së kryer ka pasur një qëndrim i cili e bën të mundshme që t'i ngarkohet vepra, përkatësisht kur veprën e konsideron të veten.²⁹

Përgjegjësia penale, në kuadrin e saj përgjegjësia dhe fajësia mund të shkallëzohen varësisht se si janë kryer p.sh. a është përdorur shkallë më e madhe ose më e vogël e fajësisë dhe e përgjegjësisë.

Kryerësve të veprave penale të korrupsionit do tu shqiptohen dënime kryesore varësisht llojit të veprës penale që kanë kryer dhe shumica e dënimeve kryesore të këtyre veprave do të tregohen në Kapitullin II tek veprat penale sipas legjislacionit të Kosovës, mirëpo krahas dënimeve kryesore mund tu shqiptohen edhe këto lloje të dënimeve:

a) Dënimet plotësuese

Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal dhe veçanërisht me ndryshimet në nenin 62 dhe 63, gjykatave u jepen udhëzime të qarta për caktimin e dënimeve plotësuese për zyrtarët të cilët kanë keqpërdorur detyrat e tyre. Zgjerimi i këtyre dispozitave është bërë për shkak të rëndësisë së veprave penale që ndërlidhen me funksionet zyrtare dhe nevojës për largimin e kryerësit të veprës penale nga ai ambient për një periudhë kohore përtej asaj të caktuar në dënimin kryesor apo alternativ. Ndalesat e tilla për zyrtarët publik janë thelbësore për të siguruar besimin e qytetarëve në administratë dhe shërbejnë gjithashtu si masë e përgjithshme e parandalimit të veprave të këtilla në administratën publike.

b) *Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik*

Neni 62 i Kodit Penal ka paraparë një sistem me nivele në lidhje me ushtrimin e funksionit publik pas shqiptimit të dënimit për një vepër penale, varësisht nga lloji i dënimit dhe vepra penale. Në vijim do të ceken dispozitat kryesore që përfshijnë një shpjegim të dënimit plotësues.

Gjykata ia ndalon kryerësit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në pesë (5) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim.³⁰

²⁹ Salihu, I. E drejta penale-pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015, fq. 277.

³⁰ Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr.06/L-074, neni 62 par.1, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 24.06.2024.

Gjykata mund t'ia ndalojë kryësit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në tre (3) vjet, nëse personi ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me gjobë ose me dënim me kusht.³¹

Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo funksioneve të shërbimeve publike prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi është dënuar për ndonjërin nga veprat penale që përfshihen në Kapitullin XXXIII të Kodit të Penale.³²

Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo në shërbime publike prej një (1) deri në pesë (5) vjet, nëse i njëjti është dënuar për dhunë në familje, sipas nenit 248 të këtij Kodi.³³

c) Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Gjykata mund që të ia ndalojë kryësit të veprës penale ushtrimin e profesionit, shfrytëzimin e pasurisë në pronësi publike apo mbrojtjen e pasurisë së tillë, veprimtarisë së pavarur, detyrës administrative apo detyrave që janë të lidhura me sistemin, , nëse ai person e ka keqpërdoruar pozitën e tij me qëllim të kryerjes së veprës penale ose nëse ka arsye të pritët që ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale.

d) Urdhrat për kompensim

Neni 61 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, kërkon që gjykata të urdhërojë dëmshpërblim apo kompensim për secilën vepër penale që përfshin "vjedhjen, humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë".³⁴

Ky është dënim plotësues për të gjitha veprat penale që plotësojnë kriteret e përmendura më lartë dhe duhet të vlerësohet gjithmonë kur i pandehuri ka aftësi për të paguar. Urdhrat për kompensim duhet të kenë përparësi ndaj gjobave të caktuara si dënim kryesor nëse gjykata konstaton se kryerësi nuk është në gjendje t'i paguajë të dyja dhe se gjoba duhet të zëvendësohet me dënim tjetër kryesor ose alternativ.

Në shumicën e rasteve, viktimë e veprave nga Kapitulli XXXIII do të jetë shteti, por gjykata duhet të kuptojë se përfundimisht se viktimë e këtyre veprave penale janë vetë taksapaguesit e Republikës së Kosovës. Andaj, edhe kthimi i fondeve duhet të jetë prioritet për gjyqësorin. Në disa

³¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr.06/L-074, neni 62 par.2, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 24.06.2024.

³² KPRK, neni 62 par.3.

³³ KPRK, neni 62 par.4.

³⁴ KPRK, neni 61.

raste, përfitimi pasuror i kryesit të veprës penale është i barabartë me lartësinë e dëmit të shkaktuar viktimës. Në raste të tilla gjykata duhet ta konfiskojë përfitimin material dhe me të përmbush kërkesën për kompensim ose dëmshpërblim. Por, mosrealizimi i kërkesës për konfiskim të përfitimeve materiale nuk duhet të ndikojë në aftësinë e gjykatës për t'ia dhënë shumën si dëmshpërblim viktimës kur të dyja janë të njëjta nëse viktima ka përmbushur kriteret për kërkesë pasuroro-juridike.

e) Dënimi me kusht

Është një mekanizëm për ta bërë dënim proporcional kur një gjë e tillë është e përshtatshme. Mirëpo, nëse përdoret shumë ose pa dallim dhe pa arsye, ai mund të bëjë që të humb besimi i publikut për sistemin e drejtësisë dhe efektin e tij parandalues. Shqiptimi i dënimit me kusht pa përmendur rrethanat që paraqesin rrethanë jashtëzakonisht lehtësuese që do të qonin në zbutje të dënimit dhe paraqet tejkalim të autorizimeve që një gjykatë ka me ligj. Edhe pse KPK lejon përdorimin e dënimit me kusht për një numër të madh të veprave, duke i përfshirë disa vepra të rënda, gjyqtarët duhet të mbajnë në mend parimet dhe qëllimin e dënimit para se të vendosin për shqiptimin e dënimit të tillë ndaj një të pandehuri për veprat penale të lidhura me korrupsionin. Vetëm pse Kodi lejon një mundësi të tillë nuk do të thotë se ekziston mundësi absolute për shqiptimin e dënimit me kusht. Është me rëndësi që gjykatat të shpjegojnë pse kërcënim i dënimit me burg, si përbërës thelbësor i dënimit me kusht, është i mjaftueshëm për ta rehabilituar të pandehurin dhe ti shërbejë qëllimeve të tjera të dënimit.

Me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit dhe as më e gjatë se pesë (5) vjet.³⁵

Në dënimin me kusht, gjykata mund të caktojë që dënimi të ekzekutohet nëse në afatin e caktuar personi i dënuar nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenson dëmin që e ka shkaktuar me vepër penale ose nuk i përmbush detyrimet e tjera të parapara me dispozitat e KPRK. Gjkata cakton afatin për përmbushjen e këtyre kushteve në kuadër të kohës së verifikimit.³⁶

Krahas shqiptimit të obligimeve të tjera, tek veprat që lidhen me korrupsion dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare është po aq e rëndësishme shqiptimi i dënimit plotësues që ka të bëjë me ndalimin e ushtrimit të funksionit, edhe me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht. Në fund, kur shqiptohet dënimi me kusht, ai duhet të shoqërohet me detyrime të tjera për të pandehurin. Detyrimet e tilla janë të paraqitura në mënyrë numerike në nenin 56 të Kodit Penal dhe detyrimet më të rëndësishme për këtë kategori të kryerësve do të ishin tre detyrimet në vijim:

³⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr.06/L-074, neni 48 par.2, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 24.06.2024

³⁶ KPRK, neni 48 par.3.

1. Të bëjë kompensimin apo të dëmshpërblejë viktimën e veprës penale;
2. Të kthejë dobinë pasurore e cila është fituar me kryerjen e veprës penale;
3. Të ofrojë raporte financiare ashtu siç kërkohet nga gjykata.³⁷

Dënimi me kusht është paraparë edhe me Ligjin Nr.04/L-03 për përgjegjësinë e personave juridikë, i cili në këtë rast do të nënkuptonte pezullimin e dënimit me gjobë prej 50.000 € me një kohë verifikimi dy vite nëse krimi është kryer për qëllime të përfitimit pasuror.³⁸

f) Konfiskimi

-Konfiskimi i përfitimit material dhe urdhri për kompensim

Pa marrë parasysh nëse dënimi është dënim me burg, dënim me kusht, punë në dobi të përgjithshme, gjobë apo ndonjë dënim tjetër plotësues, gjykata duhet të sigurohet që konfiskimi dhe dëmshpërblimi të bëhen në mënyrë të pavarur dhe në pajtim me Kodin Nr.08/L-032 të Procedurës Penale të Kosovës. Në rastet kur i pandehuri nuk është në gjendje t'i përmbushë të gjitha detyrimet financiare që parashihen nga gjykata, përparësia është kështu dëmshpërblimi i viktimave, konfiskimi i përfitimeve dhe gjoba.

-Konfiskimi i instrumentalitetit dhe dobisë pasurore

Zhveshja e kriminalitetit prej përfitimeve është një preventivë e rëndësishme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe gjykata duhet të jetë e vendosur në shqiptimin e masave të konfiskimit. Për më shumë, neni 92 i Kodit Penal paraqet një dispozitë të detyrueshme të zëvendësimit të pasurisë që do të thotë se secili fond ose pronë në posedim të të pandehurit mund të përdoret për të përmbushur urdhrin e konfiskimit, edhe nëse i pandehuri i ka fituar fondet ose pasurinë në mënyrë të ligjshme. Derisa dispozitat e konfiskimit vlejnë për të gjithë Kapitullin XXXIII, për gjykatën me rëndësi duhet të jenë këto nene, nenin 414 "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", nenin 416 "Keqpërdorimi i informatës zyrtare", nenin 418 "Përvetësimi në detyrë" dhe nenin 429 "Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor." Tek këto vepra penale, qëllimi për të përfituar dobi materiale apo përfitim material është element i veprës penale, dhe në disa raste në fakt marrja e përfitimit do ta rëndojë dënimin. Në të gjitha këto situata, Gjukata duhet të jetë e vëmendëshme për ta parë nëse me të vërtetë ka pasur përfitim pasuror dhe të adresojë çështjet e duhura me prokurorin nëse dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për konfiskim nuk janë përmbushur, por është e qartë se kryerësi ka pasur përfitim material nga kryerja e veprës penale. Me rëndësi është se pa marrë parasysh se cila procedurë do të ndiqet është esenciale të shikohet potenciali për konfiskim të pasurisë. Është po ashtu me rëndësi që të ceket nëse vepra penale është kryer për qëllim të

³⁷ Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr.06/L-074, neni 56, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 24.06.2024.

³⁸ Ligji për përgjegjësinë e personave juridikë Nr.04/L-03-03, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2766>, shfletuar më 21.07.2024.

përfitimit personal, për përfitim të personit të tretë, apo për ti shkaktuar dëm një personi. Kjo e lehtëson vendimmarrjen për atë se çfarë konfiskohet dhe se nga kush.

2.6 Personat juridikë si kryerës të veprës penale të korrupsionit dhe përgjegjësia e tyre

Sa i përket çështjes se personat juridikë a mund të konsiderohen subjekte të së drejtës ka pasur mendime të ndryshme në fushën e së drejtës penale dhe në legjislacionin penal. Janë dy koncepte ku sipas të parit personat juridikë s'mund të jenë subjekte të së drejtës, ndërsa sipas të dytit personat fizikë janë subjekte të së drejtës.³⁹

Konventa për korrupsionin e së drejtës penale të Këshillit të Europës e vitit 1999 dhe Protokollin i dytë i BE-së për Konventën për mbrojtjen e interesave financiare të komuniteteve europiane e vitit 1997 janë standardet ndërkombëtare të vetme që përkufizojnë “personat juridikë”. Neni 1(d) i Konventës së Këshillit të Europës thotë: person juridik do të thotë secili subjekt që e ka këtë status sipas ligjit kombëtar në fuqi, përpos shteteve apo organeve të tjera publike në ushtrimin e autoritetit shtetëror dhe për organizatat ndërkombëtare publike.⁴⁰

Si parim i përgjithshëm, personi juridik mund të mbajë përgjegjësi vetëm për veprat e kryera nga një person fizik nëse mund të provohet faji që i ngarkohet personit juridik. Siç u shpjegua më parë, një person juridik, si një person artificial, është i paaftë të ketë qëllime dhe për këtë arsye nuk ka synim të posaçëm. Sidoqoftë, vendimet që merren në emër të personit juridik nga persona që drejtojnë ose kontrollojnë personin juridik mund t'i ngarkohen atyre. Si i tillë, në varësi të legjislacionit në fuqi, veprimtaria antiligjore, përfshirë vepra penale të korrupsionit, nga drejtorët, punonjësit ose veprimet e një personi juridik mund t'i ngarkohet personit juridik në rrethana të caktuara.

Sipas nenit 37 të KPRK, personi juridik është përgjegjës për veprën penale të kryer nga personi përgjegjës, i cili veprën e ka kryer duke vepruar në emër të personit juridik dhe për dobi apo interesin e tij ose me atë vepër penale është shkaktuar dëm.⁴¹

³⁹ Salihu, I. E drejta penale-pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015, fq. 191.

⁴⁰ Konventa për korrupsionin e së drejtës penale të Këshillit të Europës e vitit 1991, e qasshme në <https://rm.coe.int/168007f3f5>, , shfletuar më 24.06.2024.

⁴¹ Kodi penal i Republikës së Kosovës Nr.06/L-074, neni 37, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 22.08.2024.

Ndërsa sipas paragrafit të katërt: Përgjegjësia penale e personit juridik nuk përjashton nga përgjegjësia penale një person përgjegjës i cili ka kryer, organizuar, nxitur ose ndihmuar në kryerjen e të njëjtës vepër penale.⁴²

Ekzistojnë tre lloje kryesore të fajit, të cilat paraqesin konceptet e përgjegjësisë:

1. Faji objektiv: personi juridik është përgjegjës nëse provohet se nuk ka rregullore organizative, një kulturë etike të korporatës dhe përpjekje të besueshme për pajtueshmëri. Doktrina e “fajit objektiv” nuk bazohet në fajin personal; përkundrazi, një person juridik mund të jetë përgjegjës bazuar në ndërtimin e vetë korporatës. Është një reflektim i dështimit prej pakujdesisë (ose të qëllimshëm) të të gjithë organizatës dhe ka të bëjë me “përqendrimin në nëse një ‘person i përgjegjshëm’ ishte i pakujdesshëm, sesa në dëmin kolektiv të shoqërisë për të siguruar që procedurat e duhura anti-mito ishin në zbatim.”⁴³

2. Mungesa e mbikëqyrjes: personi juridik është përgjegjës nëse një nga punonjësit e tij me kompetenca përkatëse nuk arrin të mbikëqyrë vartësit siç duhet. Ndërsa doktrina e “fajit objektiv” është “jopersonale” sepse nuk kërkon faj personal, doktrina e “mungesës së mbikëqyrjes” e kërkon atë. Në fakt, doktrina e mungesës së mbikëqyrjes kërkon që të ketë, së paku, dy persona me faj brenda shoqërisë: faji i vartësit që ka bërë shkeljen dhe faji i mbikëqyrësit.

3. Përgjegjësi e ngushtë: personi juridik është përgjegjës pasi faji i personit fizik do t’i ngarkohet automatikisht personit juridik. Nën këtë doktrinë, nuk ka asnjë faj shtesë të korporatës përveç fajit që rrjedh nga vetë punonjësi i korruptuar. Me fjalë të tjera, i vetmi “faj” i personit juridik mund të jetë thjesht se ata kanë punësuar autorin e veprës antiligjore.⁴⁴

Përgjegjësia e personave juridikë në Kosovë është përcaktuar me ligj të vecantë i cili emërtohet “Ligji për përgjegjësinë e personave juridik për veprat penale”, ku thuhet se i tërë personeli do të përgjigjet vetëm për dëmin e shkatuar nga vepra penale. Kjo përgjegjësi do të konsistojë në dënimin me gjobë, kompensimin e dëmit, kthimin e dobisë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme, ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së caktuar etj.⁴⁵

2.7 Sfidat në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë

Korniza për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, mund të konsiderohet se në përgjithësi ekziston në Kosovë. Agjencia Kundër Korrupsionit është ndër institucionet kryesore në këtë aspekt. Veprat e lidhura me këto fenomene janë të sanksionuara me

⁴² Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr.06/L-074, neni 37 par.4, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 22.08.2024.

⁴³ Mbretëria e Bashkuar (2009), Përgjigja e Qeverisë ndaj Përfundimeve dhe Rekomandimeve të Raportit të Komitetit të Përbashkët mbi Projektligjin për Korrupsionin, <https://www.gov.uk/official-documents>.

⁴⁴ Vermeulen G. dhe të tjerë (2012), Përgjegjësia e Personave Juridikë për Vepra Penale në BE.

⁴⁵ Salihu, Ismet, E drejta penale-pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015, fq.195.

KPK dhe procedura e përcaktuar në KPPK ofron bazë për ndjekjen e tyre me sukses. PSRK ka kompetencë ekskluzive në ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe kompetencë plotësuese për rastet e korrupsionit në nivel të lartë. Edhe pse janë ndërmarrë hapa, këto fenomene negative janë prezente në shoqërinë e Kosovës dhe problem paraqet parandalimi, luftimi dhe sanksionimi i tyre. Për momentin në Kosovë është një numër i madh i institucioneve të përfshira direkt ose indirekt në luftën kundër korrupsionit, por është vështirë të identifikohet se ku ka ngecje sistemi sepse ato nuk janë të integruara mirë në mes vete.

Deklarimi i pasurisë nga zyrtarët është prej masave që duhet të siguroj parandalimin, por edhe të mundësoj zbulimin e veprave penale. Mirëpo sistemi aktual i deklarimit i ka mangësitë e tij, këto shprehen së pari në konceptet përkufizuese, ku përkufizimet për zyrtarët nuk janë të harmonizuara mirë dhe mungon përkufizimi i dhuratës. Gjithashtu, formularët e deklarimit nuk janë të rregulluar në bazë të gradave të ndryshme të zyrtarëve, dhe nuk bëhet vlerësim i pozitave më të ndjeshme ndaj rrezikut të korrupsionit, por detyrohen të deklarojnë pasurinë të gjithë zyrtarët e lartë në kuptimin gjenerik. Verifikimi i deklarimeve ka të metat e saj gjithashtu, ku burime tjera të informacionit nuk merren parasysh në bazë të ligjit, si dhe mungon një proces standard i verifikimit si dhe bashkëpunimi me qeveritë tjera për të marrë informacione për pasuritë e jashtëligjshme që mund të gjenden jashtë vendit.

Pavarësisht të metave që shfaqen në parandalim, disa nga veprat e krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë shpeshherë edhe zbulohen. Por, fatkeqësisht mesatarja e atyre që sanksionohen është mjaft e vogël nëse krahasohet me vendet e zhvilluara.

Konfiskimi i pasurisë së përdorur për të kryer ose që rrjedh nga veprat penale mbetet gjithashtu sfidë kyçe. Anipse, që një pjesë e caktuar e pasurisë së tillë sekuestrohet në mënyrë të suksesshme, ajo kryesisht nuk konfiskohet me vendim përfundimtar të gjykatave. Sipas strategjisë për sundimin e ligjit të publikuar nga Ministria e Drejtësisë⁴⁶, në vitin 2018, vetëm 1% e pasurisë së sekuestruar ka përfunduar me konfiskim.

Nëse duam vërtetë që ta luftojmë korrupsionin, një nga strategjitë më të rëndësishme që duhet përdorur është që këtyre njerëzve të korruptuar t'u merren fitimet të cilat rrjedhin nga krimi i korrupsionit.⁴⁷

Korrupsioni dhe luftimi i tij ende paraqet një rën prej sfidave kryesore për vendin tonë. Veprimet e suksesshme në luftën kundër korrupsionit duhet të fokusohen në vetë individët dhe sistemet. Duhet të ekzistojë një sistem i cili është në funksion të ndërtimit të vetëdijes dhe njohurive duke e bërë të sigurt krijimin e sistemeve transparente dhe rutinave që ulin rrezikun dhe krijojnë mundësimin e dukurisë së korrupsionit.

⁴⁶ Strategjia për sundimin e ligjit 2021-2026, e qasshme në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Strategjia-per-Sundimin-e-Ligjit.pdf>, shfletuar më 22.08.2024.

⁴⁷ Duk V. Trang, Instituti për Politikën Kushtetuese dhe Legjislative, "Korrupsion dhe Demokraci", Institucionet, Proceset dhe Korrupsioni Politik në vendet në tranzicion të Evropës Qendrore dhe në ish-Bashkimin Sovjetik, 1994, fq.115.

Këshilli i Europës në vitin 1992 krijoi një grup mbi korrupsionin, duke zyrtarizuar korrupsionin si një çështje që ka nevojë për rregullim të posaçëm. Pas tyre, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore më 1998 e shpallën luftën kundër korrupsionit një ndër kriteret e reja për një administrim më të mirë ekonomik.⁴⁸

Duke cekur se korrupsioni nuk është vetëm një çështje e brendshme e shteteve që kanë probleme me korrupsion, por ai është pjesë e interesit ndërkombëtar.

Autori shqiptar Gjonça si detyra të përhershme të bashkëpunimit ndërkombëtar në sferën juridike rekomandon:⁴⁹

- Të afrohet legjislacioni kombëtar me atë ndërkombëtar, sidomos atë që rregullon praninë e shtetit në ekonomi.
- Të vazhdohet procesi i aderimit, ratifikimit dhe nënshkrimit të instrumenteve ndërkombëtare në fushën penale.
- Zgjerimi dhe përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor me vendet e tjera nëpërmjet marrëveshjeve bileaterale dhe multilaterale.
- Të krijohet sistem i rrjetit gjyqësor midis institucioneve shqiptare dhe të huaja në fushën e çështjeve juridiko-penale.
- Bashkëpunim në fushën e dorëzimit të kriminelëve dhe ekstradimit të tyre.
- Bashkëpunim për transferimin e ndjekjes penale.
- Bashkëpunim për transferimet e personave të dënuar.
- Njohjen dhe aderimin në marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare që rregullojnë marrëdhëniet ndërkombëtare në fushat përkatëse.
- Bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimet e krimeve financiare dhe të pastrimit të parave, ku të përfshihen bashkëpunimi përkatës i institucionalizuar ndërmjet partnerëve ndërkombëtarë dhe Policisë së Shtetit, policia gjyqësore, policia financiare, prokuroria si dhe njësitë e shërbimit sekret etj.
- Lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe me shtetet që kanë shkëmbime ekonomike për të rregulluar marrëdhëniet në këtë fushë.

Ndër elementet thelbësore në luftën kundër korrupsionit mund të përmenden:

Përcaktimi dhe vendosja e paluhatshme e udhëheqjes politike të vendit dhe të gjithë organeve të tyre kundër korrupsionit; Organizimi dhe bashkëpunimi institucional në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar kundër korrupsionit; Sigurimi i dhënies së përgjegjësisë të gjithë atyre në administratën shtetërore, qeveri, parti, që përfshihen në korrupsion; Reformimi i policisë dhe gjyqësisë në drejtim të organizimit të organeve të specializuara për luftimin e krimit të organizuar e korrupsionit në veçanti etj. Gjithashtu duhet theksuar edhe rolin e mediave dhe organizatave joqeveritare në luftën kundër korrupsionit. Dy mekanizma institucionale janë thelbësorë në ndihmën që japin për të luftuar korrupsionin në demokracitë e

⁴⁸ Latifi, V. Zbulimi dhe luftimi i Korrupsionit, Prishtinë, 2007, fq.43.

⁴⁹ Gjonça, L. Korrupsioni (Veprat penale përbërëse, krimi i organizuar), Tiranë, 2004, fq. 297-298.

reja: një media e fuqishme, agresive, e pavarur dhe një shoqëri civile e gjallë dhe e zhvilluar me organizata joqeveritare dhe grupe të interesit publik.⁵⁰

Përveç rregullimit legjislativ, politikës ndëshkimore, organizimit dhe ngirtjes së efikasitetit në zbulim, luftim dhe gjykim të krimit të organizuar dhe korrupsionit, planet dhe programet e fushatës të organeve qeveritare, politike dhe parlamentare duhet shtrirë dhe zbatuar në dy drejtime:

1. Cdo bartës i funksioneve politike, publike dhe profesionale për të cilin përfolet ose në çfarëdo mënyre mësohet për tolerimin ose lejimin e keqpërdorimit, për shkak të përgjegjësisë politike, të suspendohet, largohet ose shkarkohet nga detyra. Kryerja e detyrave dhe autorizimeve të shtetit është "politikë" kurse moskryerja, shpërdorimi, tolerimi i veprimtarisë kriminale nënkupton edhe përgjegjësi politike. Në raste të caktuara, kjo përgjegjësi politike mund të kryhet edhe me dorëheqje. Involvimi eventual i tij në veprimtari kriminale është çështje e organeve të zbulimit, ndjekjes dhe gjyqimit. Për këtë nuk bëhen rekomandime, insistime, premtime autoritative por organet përkatëse, sipas detyrës zyrtare, hetojnë dhe provojnë çdo kryes të veprimtarisë kriminale.
2. Zyrtarët duke filluar nga punonjësi administrative e deri tek presidenti në raste të përfshirjes (në bazë të përfoljes, deklaratave të palëve, publikimeve etj) në korrupsion ose në kryerjen e detyrave joefikase, shpërdorimin e autorizimeve, tolerimin e keqpërdorimit të detyrës, mundësimin ose ndihmën në këto dukuri, në përgjegjësi morale-si akt moral, vetë të largohet nga detyra posti zyrtar pa procedure të veçantë.

Pra, zbatimi i përgjegjësisë politike dhe përgjegjësisë morale, të bëhen mekanizma institucional për parandalimin dhe luftimin e njërës palë-palës zyrtare, në të gjitha format e korrupsionit, shpërdorimit të pushtetit dhe autorizimeve.

⁵⁰ Latifi, V. Zbulimi dhe luftimi i Korrupsionit, Prishtinë, 2007, fq.53.

KAPITULLI III

VËSHTRIM KRAHASUES I KORRUPSIONIT

3.1 Korrupsioni sipas legjislacionit penal të Republikës së Kosovës

Kosova si një vend në tranzicion që ishte, në fillet e saj me mungesë të institucioneve shtetërore e pas krijimit të tyre me mungesë të efikasitetit, me probleme të ndryshme, ka bërë që korrupsioni të vazhdojë të shfaqet në të gjithë sferat e jetës dhe të bëhet pengesë serioze për zhvillimin e vendit dhe njëkohësisht qendër e krimit të organizuar.

Ka shumë raporte prej organizatave vendore e të huaja që e renditin korrupsionin si njërin ndër problemet më aktuale të shoqërisë kosovare.

Për vite me radhë, niveli i lartë i korrupsionit në Kosovë është konsideruar si njëri prej faktorëve që ndikojnë më së shumti në parandalimin e zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës. Korrupsioni ndikon në abuzim të të hollave të tatimpaguesve, trajtim të pabarabartë të qytetarëve dhe bizneseve, në shërbime jocilësore, pasurim të paligjshëm të zyrtarëve publik dhe përkeqësim të vazhdueshëm të mirëqenies së qytetarëve.

Përkufizimin për termin korrupsion e ka dhënë edhe ligji Nr. 2004/34 “Kundër korrupsionit”, i cili në nenin 2 thoshte se: Korrupsion nënkupton çdo shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shpërblimi që drejtpërdrejt ose tërthorazi është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për t’u marrë për veten apo për një person tjetër.⁵¹

Në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës ishin parashikuar këto veprat penale: përdorimi i paautorizuar i pasurisë, zbulimi i fshehtësive zyrtare, falsifikimi i dokumentave zyrtare, ushtrimi i ndikimit, arkëtimi dhe pagesa e paligjshmemarrja e ryshfetit, dhënia e ryshfetit, lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria, mashtrimi në detyrë, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit, përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor.⁵²

Në vitin 2013 KPK u pasurua me disa figura të reja të veprave penale kundër korrupsionit ku dhe u ashpërsuan dënimet penale për subjektet aktiv të veprave penale kundër korrupsionit.

KPK i riu në Kapitullin XXXIII i ka parashikuar veprat e korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare të cilat janë këto:

⁵¹ Ligji kundër korrupsionit nr. 2004/34 neni 2, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2441&langid=1>, shfletuar më: 08.07.2024

⁵² Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8674>, shfletuar më 07.09.2024

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar(neni 414), keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik (neni 415), keqpërdorimi i informatës zyrtare (416), konflikti i interesit (417), përvetësimi në detyrë (418), mashtrimi në detyrë (419), përdorimi i paautorizuar i pasurisë (neni 420), marrja e ryshfetit (neni 421), dhënia e ryshfetit (neni 422), dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar (neni 423), ushtrimi i ndikimit (neni 424), nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 425), zbulimi i fshehtësisë zyrtare (neni 426), falsifikimi i dokumentit zyrtar (neni 427), arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme (neni 428), përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor (neni 429), mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare (neni 430), ndërsa si vepra penale të korrupsionit privat janë këto: keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike (neni 284), lidhja e kontratës së dëmshme(neni 285).⁵³

- Figurat e disa veprave penale të korrupsionit sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Neni 414 parasheh: *Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.*⁵⁴

Dispozita në paragrafin e tretë tregon se shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshin mirëpo nuk kufizohet në: shkeljen me dashje të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit; moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj; tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, pranimi i dhuratës përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj; keqpërdorimi i pasurisë, shërbimeve apo personelit qeveritar apo i ndonjë sendit tjetër me vlerë, që i përket qeverisë e që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit si rezultat i detyrës apo punës së tij; nënshtimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë, për të cilën e di se është e kundërligjshme; ose ndalimi ose pengimi me dashje i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor.⁵⁵

Neni 415 parasheh keqpërdorimin dhe mashtrimin në prokurim publik ku thuhet: *Kushdo që me vetëdije shkel rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokumentacion të rremë, marrëveshje të fshehtë kundërligjore apo ndërmerr ndonjë veprim tjetër të paligjshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit*

⁵³ Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 07.09.2024.

⁵⁴ KPRK, neni 414 par.1.

⁵⁵ KPRK, neni 414 par.3.

*publik dhe më qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik, dënohet me gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet.*⁵⁶

Paragrafi i katërt i këtij neni thotë se në rastet e shpalljes fajtor të kryerësit, përveç dënimit, gjykata do t'i shqiptojë kryerësit ndalimin e marrjes pjesë në procedurat për dhënien e kontratave në prokurim publik. Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga personat zyrtarë që punojnë në prokurim publik.⁵⁷

Neni 416 parashikon: *Personi zyrtar i cili keqpërdor informatën zyrtare me qëllim që për vete apo për personin tjetër të përfitojë ndonjë përparësi që nuk i takon, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*⁵⁸

Te kjo dispozitë ligjore, kryesi keqpërdor informatën zyrtare me qëllimin e vetëm që vetes apo personit tjetër t'i sjellë ndonjë përparësi pasurore ose jo pasurore. Pra, këtu bëhet fjalë për një informacion të rëndësishëm, në të cilën personi zyrtar ka qasje në bazë të punës ose detyrës së tij dhe informacioni nuk e ka statusin e sekretit shtetëror, por ende nuk është publikuar dhe ky informacion nga personi zyrtar shfaqet tek persona të tjerë, me qëllim të realizimit të ndonjë përparësie për vete apo për ndonjë person tjetër.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga personi zyrtar dhe vetëm me dashje.

Neni 417 i cili përcakton konfliktin e interesit thotë se: *Personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare për të cilën e ka ditur apo është dashur ta dijë se ai apo ajo, ndonjë anëtar i familjes së tij ose të saj, ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të, ka interes financiar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, dhe nëse çështja zyrtare është veprim i prokurimit apo ankand publik, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.*⁵⁹

Shprehja “çështje zyrtare” nënkupton një procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar, aplikim; kontratë ose kërkesë; ankand publik; ose ndonjë çështje tjetër e cila prek interesat financiare të personit zyrtar, anëtarit të familjes apo ndonjë personi juridik që ka të bëjë me të.

Neni 418 parasheh: *përvetësimin në detyrë ku thotë, personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, përvetëson pasurinë e cila i është besuar për shkak të detyrës apo pozitës së tij, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*⁶⁰

⁵⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074, neni 415 par.1, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 07.09.2024.

⁵⁷ KPRK, neni 415 par.4.

⁵⁸ Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074, neni 416 par.1, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 07.09.2024.

⁵⁹ Po aty, neni 417 par.1.

⁶⁰ Po aty, neni 418 par.1.

Sipas paragrafit të dytë, nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore ose humbje në vlerë që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Përvetësimi në detyrë mund të kryhet nga zyrtari publik me dashje të drejtpërdrejtë.

Neni 419 parashikon: *Personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, bën krijimin, përdorimin ose prezantimin e rremë të raportit të llogarive apo në ndonjë mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës ose transferit të kundërligjshëm të parave, pasurisë ose të drejtave tjera, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Në paragrafin e tretë parashikohet si element cilësues, kur nga vepra penale rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro si dhe në paragrafin e katërt (50.000) Euro. Ky element cilësues përcakton dënimin e kryesit të veprës penale ku tek paragrafi i tretë dënimi mund të shkojë më së shumti në (8) vjet, e tek paragrafi i katërt dënimi mund të shkojë më së shumti (12) vjet.⁶¹

Neni 421 parasheh figurën e veprës penale të korrupsionit pasiv ku kjo vepër penale kryhet vetëm nga personat zyrtar me dashje të drejtpërdrejtë, ku vepra penale konsiderohet e kryer kur *personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.*⁶²

Elementi cilësues parashikohet në paragrafin e tretë që thotë se nëse vepra penale nga paragrafi një, i këtij neni rezulton me dobi material në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (5) deri në tetë (15) vjet.

Neni 422 parashef figurën e veprës penale të korrupsionit aktiv ku thuhet se: *Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për vete apo për një person tjetër i premtton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë të paarsyeshme apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.*⁶³

Elementi cilësues është përcaktuar në paragrafin e tretë ku thuhet se, nëse vepra penale nga paragrafi një i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.⁶⁴

⁶¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074, neni 419 par.1, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 07.09.2024.

⁶² Po aty, neni 421 par.3.

⁶³ Po aty, neni 422 par.1.

⁶⁴ Po aty, neni 422 par.3

Neni 423 parasheh dhënien e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar ku thuhet se: *Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër zyrtarit publik të huaj apo personit të huaj zyrtar, për veten ose për personin tjetër, në mënyrë që ai zyrtar i huaj publik apo personi i huaj zyrtar ose personi tjetër të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.*⁶⁵

Elementi cilësues haset në paragrafin e tretë ku nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet. Gjithashtu dhurata ose përfitimi i pranuar ose ofruar në kundërshtim të këtij neni nuk konfiskohet.⁶⁶

Neni 426 parasheh zbulimin e fshehtësisë zyrtare ku thuhet se: *Personi zyrtar i cili pa autorizim kumton, dërgon ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion personit tjetër informatën që përbën fshehtësi zyrtare ose siguron informatën e tillë me qëllim që t'ia përcjellë ndonjë personi të paautorizuar, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.*⁶⁷

Kjo vepër penale mund të kryhet edhe nga pakujdesia, gjithashtu paragrafi i katërt thotë se dispozitat e këtij neni zbatohen ndaj personit i cili zbulon fshehtësinë zyrtare edhe pasi që të ketë pushuar statusi i tij zyrtar.⁶⁸

Neni 428 parasheh, arkëtimin dhe pagesa e kundërligjshme i cili thotë se: *Personi zyrtar i cili arkëton nga tjetri diçka që personi i tillë nuk është i detyruar të paguajë ose arkëton më shumë se që personi i tillë është i detyruar të paguajë apo që gjatë pagesës ose dërgesës, paguan ose dërgon më pak se që është dashur, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.*⁶⁹

Element cilësues është shfaqur në paragrafin e dytë, ku nëse vlera e pagesës apo dërgesës nga paragrafi një i këtij neni tejkalon shumë prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet. Gjithashtu tentativa për ta kryer këtë vepër penale është e dënueshme.⁷⁰

Neni 429 parasheh përvetësimin e kundërligjshëm të pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor ku thuhet se: *Personi zyrtar i cili gjatë bastisjes së lokaleve, personit apo gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor, merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përfitimit të dobisë*

⁶⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074, neni 423, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 07.09.2024.

⁶⁶ KPRK, neni 423 par.3.

⁶⁷ Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074, neni 426, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 07.09.2024.

⁶⁸ KPRK, neni 426 par.4.

⁶⁹ Po aty, neni 428.

⁷⁰ Po aty, neni 428 par.2.

*pasurore për vete ose për personin tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*⁷¹

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga personat zyrtarë.

Neni 430 është mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare ku parasheh: *Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës.*⁷²

Këtë vepër penale mund ta kryejnë vetëm personat që duhet ta deklarojnë pasurinë. Sipas paragrafit të tretë vlera e padeklaruar ose e deklaruar rrejshëm e pasurisë, të ardhurave, dhuratave ose të dobisë tjetër pasurore konfiskohet.

Neni 284 parashikon: Personi përgjegjës që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike kryen një nga veprimet në vijim me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për ndonjë person tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.⁷³

Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton në dobi pasurore që tejkalon njëqindmijë (100.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.⁷⁴

Neni 285 parasheh: 1. Personi përgjegjës i cili ushtron veprimtari ekonomike që lidh kontratë për të cilën e di se është e dëmshme për organizatën e biznesit apo që lidh kontratë në kundërshtim me autorizimet e tij dhe me këtë i shkakton dëm organizatës së biznesit, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.⁷⁵

Kur kryesi i veprës nga paragrafi 1. i këtij neni merr ryshfet ose shkakton dëm në shumën që tejkalon njëqindmijë (100.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.⁷⁶

⁷¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074, neni 429, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 10.09.2024.

⁷² Po aty, neni 430 par.1.

⁷³ Po aty, neni 284 par.1.

⁷⁴ Po aty, neni 284 par.2.

⁷⁵ Po aty, neni 285 par.1.

⁷⁶ Po aty, neni 285 par.2.

3.2. Korrupsioni sipas legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë

Në vitin 2023 Shqipëria u vlerësua në me një pikë më shumë se në vitin 2022 në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit, duke shënuar 37 pikë dhe duke u radhitur në vendin e 98-të mes 180 vendeve, sipas organizatës Transparency International.⁷⁷

Transparency International përdor një sistem të llogaritjes të indeksit nga 0 deri në 100 pikë, ku zero është niveli më i lartë i korrupsionit dhe 100 pikë do të thotë mungesë korrupsioni.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria radhitet më poshtë se Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, ndërsa ka një pikë më shumë se Serbia dhe dy më shumë se Bosnja.⁷⁸

Renditja më e ulët e Shqipërisë ishte në vitin 2005, përkatësisht në vendin e 126-të. Pozicionin më të mirë e ka pasur në vitin 2016, në vendin e 83-të nga 176 vende gjithsej dhe në vitin 2008, në vendin 85-të nga 180 vende gjithsej. Duket se qeveritë në Shqipëri gjatë mandatit të parë bëjnë përmirësim në uljen e nivelit të korrupsionit, por pas fillimit të mandatit të dytë fillon rritja e nivelit të korrupsionit më shumë.⁷⁹

Legjislacioni penal si dhe zbatimi i tij përbën garancionin më të madh për luftën kundër korrupsionit. Legjislacioni penal karakterizohet nga shtimi i figurave të veprave penale kundër korrupsionit si dhe nga politika e ashpërsimit të dënimeve. Ky legjislacion identifikohet me:

1. Seksionin X, nën titullin vepra penale kundër fëmijëve, martesës, familjes, i cili parashikon figurën e veprës penale kërkimi ose marrja e shpërblimeve në procedurat e birësimit (nenin 124/a);
2. Seksioni IV, i cili parasheh figurat e veprave penale të kryera në shoqëritë tregtare (neni 164/a, neni 164/b);
3. Kreu III, seksioni I, i cili parasheh figurat e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit (neni 244, 244/a, 245, 245/1);
4. Seksioni II: "Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik", i cili parashikon figurat e veprave penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike (neni 259); korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë (neni 259/a); korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë (neni 260);
5. Kreu IX, nën titullin vepra penale kundër drejtësisë, në të cilin parashikohen figurat e veprave penale të korrupsionit aktiv të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit (neni 312); korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë (neni 319); korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare (neni 319/a); korrupsioni aktiv i arbitrit

⁷⁷ Raport i Transparency International, i qasshëm në: <https://www.transparency.org/en/countries/albania>, shfletuar më 02.07.2024.

⁷⁸ Raport i Transparency International, i qasshëm në: <https://www.transparency.org/en/news/cpi-2023-eastern-europe-central-asia-autocracy-weak-justice-systems-widespread-enabling-corruption>, shfletuar më 02.07.2024.

⁷⁹ Artikull i qasshëm në: <https://ndiqparate.al/?p=19939>, shfletuar më 21.06.2024.

vendas edhe të huaj (neni 319/b); korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja (neni 319/c); korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë (neni 319/ç); korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare (neni 319/d); korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj (neni 319/dh); korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja (neni 319/e);

6. Kreu X, nën titullin vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, ku parashikohet figura e veprës penale të dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve (neni 328), dispozitë, e cila është ndryshuar me ligjin nr.23/2012, të datës 1.03.2012, neni 50.

7. Figurat e veprave penale, të cilat nuk janë formuluar me terminologjinë vepra penale kundër korrupsionit, por që nga interpretimi i zgjeruar i tyre, kanë elemente të veprave penale të korrupsionit, të tilla si shpërdorimi i detyës (neni 248); dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore (neni 248/a); shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti (neni 256); mos kryerja e detyrave nga organet tatimore (neni 181/a); marrja e shpërblimeve (neni 217); përfitimi i paligjshëm i interesave (neni 257); refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim (neni 257/a); shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike (neni 258).⁸⁰

- Figurat e disa veprave penale kundër korrupsionit sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

Neni 124/a parasheh kërkimin ose marrjen e shpërblimeve për procedurat e birësimit ku thotë se: *Kërkimi, propozimi, dhënia ose pranimi i shpërblimeve dhe përfitimeve të tjera, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me procesin e birësimit të një të mituri, dënohen me burgim deri në shtatë vjet.*⁸¹

Kjo vepër penale kryhet me veprim ose mosveprim, që lidhet me procesin e birësimit të një të mituri. Kryerja e veprës penale nuk lidhet me ardhjen e pasojave, pasi që vepra penale konsiderohet e kryer edhe kur subjektet kërkojnë dhënien e shpërblimeve dhe përfitimeve pa marrë parasysh qfarë lloji i shpërblimit si në të holla, sende etj. Kjo vepër kryhet vetëm me dashje direkte.

Neni 164/a parashikon korrupsionin aktiv në sektorin privat i cili thotë se: *Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloji përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që ushtron funksion drejtues në shoqëri tregtare ose punon në çdo pozicion në sektorin*

⁸⁰ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë Ligj nr.7895-1995, i qasshëm në: https://qbz.gov.al/share/_YCvI02dROybrYpg2hNERg, shfletuar më 03.07.2024.

⁸¹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë Ligj nr.7895-1995, neni 124/a, i qasshëm në: https://qbz.gov.al/share/_YCvI02dROybrYpg2hNERg, shfletuar më 03.07.2024.

*privat, për të kryer ose moskryer një veprim në kundërshtim me detyrën ose funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.*⁸²

Kundërvajtja këtu kryhet me veprime të premtimit, propozimit të drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt personit që ushtron funksion drejtues në shoqëri tregtare ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, duke u konsideruar e kryer edhe pa ardhur pasojat pasi mjafton propozimi apo premtimi. Kjo kundërvajtje penale kryhet me dashje të drejtëpëdrejtë dhe me qëllim përfitimi.

Neni 164/b parashikon korrupsionin pasiv në sektorin privat ku thotë se: *Kërkimi a marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt a i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksion drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.*⁸³

Korrupsioni pasiv në sektorin privat kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim përfitimi nga subjekti i veçantë. Sipas legjislacionit penal të Shqipërisë dënimi është më i rëndë sesa për kundërvajtjen penale të korrupsionit aktiv në sektorin privat për arsyet të rrezikshmërisë së lartë shoqërore që ka.

Neni 244 parashikon korrupsionin aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike ku thotë se: *Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit. Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, është mbi vlerën 50.000 lekë, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një në tre vjet.*⁸⁴

Objekt i veprës penale janë marrëdhëniet juridike që janë të vendosura për të garantuar ligjshmërinë e ushtrimit të veprimtarisë administrative nga nëpunësit publikë të cilët duhet ti mbrojnë interesat shtetërore.

Kjo vepër penale kryhet me dashje me qëllim të përfitimit material.

Neni 245 parashikon korrupsionin aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor ku thotë se: *Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona*

⁸² Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë Ligj nr.7895-1995, neni 164/b, i qasshëm në: <https://qbz.gov.al/share/YCvI02dROYbrYpg2hNERg>, shfletuar më 03.07.2024.

⁸³ KPRSh, neni 164/b.

⁸⁴ KPRSh, neni 244,

*të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.*⁸⁵

Neni 245/1 parashikon ushtrimin e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike ku thotë se: *Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtun ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit.*⁸⁶

Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike që janë të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të organeve të administratës publike. Nga ana objektive kjo vepër penale kryhet nëpërmjet premtimit apo propozimit për përfitim jo të rregullt. Përfitimi mund të jetë në shërbime, para, dhurata etj. Përfitimi i jepet ose premtohet personit që premtun se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës tek personat që ushtrojnë funksione publike.

Neni 259 parashikon korrupsionin pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike ku thotë se: *Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt ose premtimi i një përfitimi të tillë është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.*⁸⁷

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike që janë vendosur për të siguruar veprimtarinë e rregullt të administratës publike, të shërbimit publik si dhe interesat e shtetit. Në veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike i pandehuri është

⁸⁵ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë Ligj nr.7895-1995, neni 245, i qasshëm në: <https://qbz.gov.al/share/YCvI02dROybrYpg2hNERg>, shfletuar më 03.07.2024.

⁸⁶ KPRSh, neni 245/1.

⁸⁷ KPRSh, neni 259.

person i cili gëzon statusin e nëpunësit publik dhe kërkon ose merr përfitimet e parregullta, në këmbim të përfundimit ose mos përfundimit së veprimeve në lidhje me detyrën publike, të cilat i sigurojnë privilegje personit që jep ose premtion përfitimin.

Që të cilësohet si korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, duhet që përfitimi të lidhet me kryerjen ose moskryerjen e një ose disa veprimeve që lidhet me funksionin. Kjo vepër penale kryehet me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim përfitimin dhe ka një rrezikshmëri të lartë shoqërore, sepse është një vepër penale që kryhet nga vetë punëtorët e shtetit që ushtrojnë një funksion publik.

Neni 260 parasheh korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendor ku thotë se: *Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte apo premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.*⁸⁸

Kjo vepër penale ka për objekt marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtari të rregullt, besim publik tek funksionarët e lartë dhe interesat e qytetarëve.

Subjekti i veprës penale është i veçantë, i cili e kryen veprën penale me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim përfitimi material.

2.3. Korrupsioni sipas legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë të Veriut

Maqedonia e Veriut është radhitur në vendin e 76-të nga gjithsej 180 shtete në listën e “Transparency International”, sipas indeksit për perceptimin e korrupsionit, duke e ndarë këtë pozicion me Moldavinë, Hungarinë, Kubën, Kinën dhe Bahreinin.⁸⁹

Edhe pse në vitin 2023 shënon ngritje prej 9 vendeve në krahasim me vitin 2022, kur vendi ka qenë në vendin e 85-të.

Në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, veprat penale të lidhura me korrupsion janë rradhitur kështu: Ryshfetin gjatë zgjedhjeve dhe votimit (neni 162), mashtrimi (247), mashtrimi i blerësve (neni 248), pranimi i paautorizuar i dhuratave (neni 253), falimentimi i rremë (neni 254), keqpërdorimi për procedurën e falimentimit (neni 256), pastrami i parave (neni 273), sigurimi dhe mashtrimi i aksioneve (neni 275), zbulimi dhe marrja e paautorizuar e sekretit afarist

⁸⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë Ligj nr.7895-1995, neni 260, i qasshëm në: https://qbz.gov.al/share/_YCVl02dROybrYpg2hNERg, shfletuar më 03.07.2024.

⁸⁹ Raport i Transparency International, i qasshëm në: <https://www.transparency.org/en/countries/north-macedonia>, shfletuar më 17.06.2024.

(neni 281), përvetësimi në shërbim (neni 354), mashtrimi në shërbim (neni 355), marrja e ryshfetit (neni 357), dhënia e ryshfetit (neni 358), pasurimi dhe fshehja e paligjshme e pasurisë (neni 359-a), zbulimi i sekretit zyrtar (neni 360), keqpërdorimi i sekretit shtetëror, zyrtar apo ushtarak (neni 360-a), falsifikimi i një dokumenti zyrtar (neni 361), arkëtimi dhe pagesa e paligjshme (neni 362), ndikimi i paligjshëm mbi dëshmitarë (neni 368-a).⁹⁰

- Figurat e disa veprave penale të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Neni 162 parashikon ryshfetin gjatë zgjedhjeve dhe votimin i cili thotë: *Një person që ofron, jep ose premtim një dhuratë ose ndonjë përfitim tjetër personal për një person me të drejtë vote, me synimin për të tërhequr këtë person për të kryer ose jo votimin të drejtën ose kryerjen e saj në një kuptim të caktuar dënohet me burgim së paku pesë vjet.*⁹¹

Dënimi nga paragrafi 1 do të zbatohet edhe për personin me të drejtë vote i cili kërkon për vete një dhuratë apo përfitim tjetër, ose kush merr një dhuratë apo një përfitim tjetër me qëllim të të realizimit të drejtës së votës. Nëse përfitimi ka vlerë më të vogël, kryesi i veprës dënohet me gjobë ose me burgim në kohëzgjatje deri në një vit. Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Neni 247 parasheh mashtrimin i cili thotë se: *Personi i cili me qëllim të përfitimit të paligjshëm pasuror për vete ose për një tjetër mashtron tjetrin me paraqitje të rreme ose duke fshehur fakte dhe me këtë i shtyn ata të bëjnë ose të mos bëjnë diçka që ju shkakton dëm të atyre ose pasurisë së tjetrit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*⁹²

Paragrafi i dytë cek se nëse dëmi është me vlerë më të vogël, dhe kryerësi ka dashur të arrijë vlerën e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Kjo vepër penale kryhet me dashje dhe me qëllim të përfitimit pasuror.⁹³

Neni 248 parasheh mashtrimin e blerësve ku thotë: *Personi i cili me qëllim të mashtrimit të blerësve lëshon për tregti produkte me etiketë në cilat të dhënat nuk korrespondojnë me përmbajtjen, llojin, origjinën ose cilësinë e produktit, ose lëshon për tregti produkte që sipas peshës apo cilësisë së tyre nuk përputhen me çfarë normalisht supozohet për këto produkte, ose produkte pa etiketë për përmbajtjen, llojin, origjinën ose cilësinë e produktit dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.* Kjo vepër penale kryhet me dashje për qëllim të përfitimit pasuror.⁹⁴

⁹⁰ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë nr. 37/06, i qasshëm në: <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BD-%D1%82%D0%B5%D0%BA%D1%81%D1%82.pdf>, shfletuar më 14.06.2024.

⁹¹ KPRM, neni 162 par.1.

⁹² KPRM, neni 247 par.1.

⁹³ KPRM, neni 247 par.2.

⁹⁴ KPRM, neni 248.

Neni 253 parasheh pranimin e paautorizuar të dhuratave ku thotë: *Ai person i cili është në kryerjen e detyrave të ekonomisë, financave, tregtisë, shërbimit ose një aktivitet tjetër ekonomik, direkt ose indirekt kërkon ose pranon të marrë për veten ose për një tjetër një dhuratë ose një përfitim tjetër të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose një peng ose një ofertë për përfitim të tillë me qëllim të neglizhimit të interesave të personit juridik ose fizik mbi lidhjen ose zgjatjen e një marrëveshjeje ose ndërmarrjen e një veprimi tjetër për të përfituar dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.*⁹⁵

Paragrafi i katërt i këtij neni thotë se organizatori ose pjesëmarrësi në një garë sportive i cili direkt ose indirekt do të kërkojë ose do të pranojë të marrë për vete ose për një tjetër një dhuratë apo një përfitim direkt dhe indirekt, një ofertë për një përfitim të tillë me qëllim që të neglizhohen interesat e personit juridik apo fizik që organizon konkursin për të arritur një rezultat të pavarur nga loja sportive dhe rregullat e garës sportive, do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga personi zyrtarë dhe kryhet me dashje direkte.⁹⁶

Neni 357 parasheh marrjen e ryshfetit ku thotë se: *Personi zyrtar i cili drejtpërdrejt ose tërthorazi kërkon ose merr një dhuratë ose ndonjë tjetër përfitim, merr premtim për dhuratë ose ndonjë përfitim tjetër, për kryerjen e një akti zyrtar brenda autorizimit të tyre zyrtar të cilin nuk duhet ta kryejnë dënohen me burgim prej katër deri në dhjetë vjet.*

Paragrafi i katërt i këtij neni thekson se nëse kryerësi ka përfituar pasuri të madhe atëherë ai do të dënohet me të paktën katër vjet burgim, ku edhe përfitimi pasuror do të konfiskohet. Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi i cili është në krye të detyrës zyrtare dhe kjo kryhet me dashje për përfitim pasuror.⁹⁷

Neni 358 parasheh dhënien e ryshfetit ku thotë se: *Personi i cili drejtpërdrejt ose tërthorazi i jep ose i premtim një personi zyrtar një dhuratë ose një tjetër përfitim, në mënyrë që të kryejë një punë të cilën nuk duhet ta kryejë, ose të mos kryejë një akt zyrtar që duhet ta kryejë dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.*⁹⁸

Paragrafi i gjashtë thotë se dhurata e dhënë do të konfiskohet. Kjo vepër penale mund të kryhet nga kushdo dhe kryhet vetëm me dashje.⁹⁹

Neni 359-a parashikon pasurimin dhe fshehjen e paligjshme të pasurisë ku thotë: *Personi zyrtar dhe personi i autorizuar në ndërmarrje publike ose institucion publik, subjekti që disponon kapital shtetëror që do të veprojë kundër detyrimit ligjor për raportimin e pasurisë ose modifikimin e tij, duke raportuar kështu dokumente false ose të pjesshme për të ardhurat e tij/saj, kur konstatojnë*

⁹⁵ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë nr. 37/06, neni 253 par.1, i qasshëm në : <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BD-%D1%82%D0%B5%D0%BA%D1%81%D1%82.pdf>, shfletuar më 14.06.2024.

⁹⁶ KPRM, neni 253 par.4.

⁹⁷ KPRM, neni 357 par.4.

⁹⁸ KPRM, neni 358 par.1.

⁹⁹ KPRM, neni 358 par.6.

se pasuria e tyre ose e familjes së tyre tejkalon dukshëm të ardhurat e raportuara të tatueshme, i shqiptohet dënimi me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe me gjobë.¹⁰⁰

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga personat zyrtar të cilëve i'u është kërkuar që të bëjnë raport mbi pasurinë e tyre dhe zakonisht kryhet me dashje.

Neni 360 parashikon zbulimin e sekretit zyrtar ku thotë: *Një person që tregon, dorëzon ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion informacion publikut ose një personi të paautorizuar, që e merr një informacion të tillë me qëllim për t'i treguar ose për t'ia dorëzuar publikut ose një personi të paautorizuar, duhet dënohet me burgim nga tre muaj deri në pesë vjet.* Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje.¹⁰¹

Neni 360-a parashikon keqpërdorimin e sekretit shtetëror, zyrtar ose ushtarak ku thotë: *Personi zyrtar që do të keqpërdor të dhënat dhe informacionet që përfaqësojnë një informacion shtetëror, zyrtar apo ushtarak të cilët janë sekret, me qëllim të përfitim personal për vete ose për personin tjetër dhe për të dëmtuar interesin e pales tjetër, dënohet me burgim nga tre muaj deri në pesë vjet.* Edhe kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje me qëllim të përfitimit pasuror.¹⁰²

Neni 361 parashikon falsifikimin e një dokumenti zyrtar ku thotë se: *Një person zyrtar që në një dokument, libër apo letër zyrtare fut informacione të pavërteta ose nuk fut disa të dhëna të rëndësishme; me nënshkrimin e tij, përkatësisht me ndonjë vulë zyrtare verifikon një dokument zyrtar dënohet me burgim nga tre muaj deri në pesë vjet.*¹⁰³

Dënimi do të zbatohet edhe për personin zyrtar i cili i përdorë dokumentet në shërbim sikur të ishin të vërteta, ose i i mbulon, shkatërron, i dëmton në masë më të madhe ose i bën të padobishme. Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga personat zyrtarë me dashje.

¹⁰⁰ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë nr. 37/06, neni 359-a, i qashtëm në : <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BD-%D1%82%D0%B5%D0%BA%D1%81%D1%82.pdf>, shfletuar më 14.06.2024.

¹⁰¹ KPRM, neni 360.

¹⁰² KPRM, neni 360-a.

¹⁰³ KPRM, neni 361

KAPITULLI IV

FENOMENOLOGJIA DHE ETIOLOGJIA E KORRUPSIONIT

4.1 Kuptimi i fenomenologjisë dhe formate paraqitjes së korrupsionit

Studimi i fenomenit të korrupsionit dhe prirjes për korrupsion mund të klasifikohet si detyrë kërkimore shumë dimensionale. Në të njëjtën kohë, analiza e faktorëve që përcaktojnë mekanizmin nxitës të korrupsionit në nivel individual është me interes të madh. Kjo e fundit, nga ana tjetër, mund të inicohet në mënyrë empirike, nëpërmjet rasteve në praktikën psikologjike ose në praktikën e vëzhgimeve të jetës, të cilat ndihmojnë në ngritjen e pyetjeve jo standarde për kuptimin dhe shqyrtimin tradicional të çështjeve të korrupsionit. Format e korrupsionit janë të shumëfishta dhe manifestimet e tij janë shumë të ndryshme: nga më të thjeshtat për shembull marrja e ryshfetit për kryerjen e veprimeve të paligjshme, deri tek ato më komplekse si p.sh shitja e posteve, lobimi i ligjeve për shpërblim etj.¹⁰⁴ Për shembull, bazuar në "*fushën e aplikimit*", dallohet korrupsioni ekonomik (ryshfet si marrje, premtim, ofertë, dhënie ose kërkim ryshfeti) dhe korrupsioni politik (i cili shoqërohet me veprimtaritë e zyrtarëve të pushtetit politik, i cili bazohet në një shkëmbim jozyrtar, të pakontrolluar të burimet ndërmjet elitës në pushtet). Si forma të korrupsionit politik janë: lobimi për korrupsion, favorizimi i korrupsionit, kontribute të fshehta politike, kontributet në zgjedhje me pagesën e mëvonshme të funksioneve publike dhe të tjera. Fenomenologjia e korrupsionit është studim i natyrës dhe karakteristikave të korrupsionit si fenomen juridik dhe social. Kjo përfshinë analizën e formave, përmasave dhe efekteve të korrupsionit në shoqëri si dhe studimin e strategjive për luftimin dhe parandalimin e tij.¹⁰⁵

Në vendet me traditë demokratike, ku sundimi i ligjit është në një nivel të lartë, korrupsioni është dukuri më e kontrolluar por jo edhe e eliminuar, mirëpo rritjen më shqetësuese korrupsioni e arrin në vendet në tranzicion. Ekzistojnë dy forma kryesore të paraqitjes së korrupsionit: forma aktive (kërkimi, oferta dhe premtimi i një përfitimi, dobie, ryshfeti ose të hollash) dhe forma pasive (pranimi i dobisë, përfitimit, ryshfetit ose të hollave pa e kërkuar atë).¹⁰⁶

“Ryshfeti” është pagesa në para apo në natyrë, që jepet apo merret në një marrëdhënie të korruptuar. Të paguash ose të marrësh ryshfet është korrupsion në vetvete dhe duhet kuptuar si thelb i korrupsionit. Një ryshfet është një shumë e caktuar e të hollave, një përqindje e caktuar e një kontrate që zakonisht i paguhet një zyrtari shtetëror që mund të bëjë kontratat në emër të shtetit

¹⁰⁴ Bratu, A, The Phenomenology of Corruption, 2015, fq.34-36.

¹⁰⁵ Po aty, fq. 84.

¹⁰⁶ Josiane Fahed- Sreih, “Corruption- New insights”, 2023, fq. 45.

ose në ndonjë mënyrë tjetër shpërndajnë përfitime për individët. Këto janë pagesa të nevojshme që kërkojnë që gjërat të kalojnë më shpejtë dhe më qetë përmes shtetit.¹⁰⁷

“Përvetësimi” është vjedhja e burimeve publike nga nëpunësit publikë, që është një formë tjetër e shpërdorimit të fondeve publike. Përvetësim është kur në një shtet nëpunësi vjedh nga institucioni publik në të cilin ka qenë i punësuar dhe nga burimet që ai supozohet që ti administrojë në emër të shtetit dhe punës së tij. Njëashtu edhe punëtorët në firma private mund të përvetësojnë para dhe burime të tjera nga punëdhënësit e tyre. Përvetësimi nuk konsiderohet si korrupsion nga pikëpamja e repte ligjore.¹⁰⁸

“Mashtrimi” është term më i gjerë ligjor dhe popullor që mbulon më shumë se ryshfeti dhe përvetësimi. Është mashtrim për shembull kur agjencitë shtetërore dhe përfaqësuesit e shtetit janë të angazhuar në rrjete të tregtisë së paligjshme, falsifikime, shantazhe dhe kur kontrabanda dhe krimet e tjera ekonomike të organizuara mbështeten me sanksione “zyrtare”. Përfshin çdo sjellje kriminale dhe të pandershme që ka për qëllim përfitimin pasuror ose personal në mënyrë të paligjshme.

“Zhvatja” nënkupton paratë dhe burimet e tjera të nxjerra nga përdorimi i dhunës apo kërcënimeve për përdorimin e forcës. Paratë e "mbrojtjes" ose "sigurisë" mund të zhvaten në stilin klasik mafioz. Duke krijuar një atmosferë pasigurie ku qytetarët, bizneset private dhe zyrtarët publikë ngacmohen dhe frikësohen, mafiozët dhe kriminelët shantazhojnë dhe zhvatin para në këmbim të tyre për një lloj të paqes së tyre. Shantazhi dhe zhvatja janë në thelb një transaksion korruptiv, ku paratë nxirren me dhunë dhe kthimet janë të pakta ose nuk ndodhin fare.¹⁰⁹

“Favorizimi” është një mekanizëm i abuzimit me pushtetin që nënkupton shpërndarjen e njëanshme të burimeve shtetërore, pavarësisht se si kanë qenë këto burime të akumuluar në radhë të parë. Favorizimi është prirja natyrore e njeriut për të favorizuar miqtë, familjen dhe këdo të afërt dhe të besuar.

Në sferën politike, favorizimi është kur zyrtarët shtetërore dhe politikanët, të cilët kanë kontroll në burimet shtetërore dhe fuqinë për të vendosur mbi shpërndarja e këtyre, japin preferencë për persona të caktuar. Favorizëm është për shembull t'i japësh një zyrë një miku ose një të afërmi, pavarësisht nga merita.¹¹⁰ Një lloj i favorizimit është edhe nepotizmi i cili është tepër i përhapur në Kosovë.

“Pastrimi i parave” Korrupsioni, përveç që siguron të ardhura që mund të pastrohen, ekziston edhe brenda fushës së pastrimit të parave. Ky i fundit njihet nga shumë autorë¹¹¹ si formë

¹⁰⁷ Bratu, A, The Phenomenology of Corruption, 2015, fq. 38.

¹⁰⁸ Josiane Fahed- Sreih, ‘Corruption- New insights’, 2023, fq. 47.

¹⁰⁹ Poda, Z. “Krimi i organizuar transaksional, sistem dhune dhe pushteti”, Tiranë, 2007, fq. 56.

¹¹⁰ Po aty, fq. 58.

¹¹¹ Azem R. Hajdari, Veprat penale me natyrë korupsioni me një vështrim të posaçëm në Kosovë, Prishtinë 2003, fq.115.

bashkëkohore e korrupsionit. Me korrupsion në fushën e pastrimit të parave nënkuptojmë veprimet e paligjshme që ndërmerren nga një zyrtar me qëllim që paratë e fituara nga transaksionet dhe aktivitetet e ndryshme kriminale të futen në veprimtari ligjore.¹¹²

Pastrimi i parave krijon kushte të favorshme për korrupsion. Grumbullimi i pushtetit financiar dhe ekonomik nga individë të korrumpuar politikanë apo të institucioneve, si dhe nëlidhje me ta nga organizimet kriminale, minon ekonominë kombëtare dhe gjithë sistemin demokratik. Pastrimi i parave dëmton reputacionin dhe ngjall frikë te investitorët e ndershëm.¹¹³

4.2 Faktorët e paraqitjes së korrupsionit

Sipas kriminologjisë bashkëkohore, për të evidentuar shkaktarët e korrupsionit, nuk bën të kufizohemi vetëm në faktorët e përgjithshëm shoqërorë dhe kulturorë, politikë, ekonomikë por edhe në faktorët që favorizojnë sjellje përkatëse individuale. Edhe veprat penale në fushën e korrupsionit dhe pastrimit të parave kanë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të paraqitjes së tyre, ku lidhja dhe ndikimi mes tyre çojnë në kryerjen e veprave penale. Ndër kushtet e përgjithshme konsiderohen: rrethanat shoqërore dhe politike, zhvillimin ekonomik, veprimtarinë e organeve shtetërore që nuk respektojnë ligjet dhe rregullat e mirëfunksionimit të tyre.¹¹⁴

Te fenomeni i korrupsionit binomi “shkak-pasojë” ndodhet në një rreth të mbyllur, ku është e vështirë të identifikosh shkaktarët ose shkakun nga pasojat dhe e anasjelltas.¹¹⁵

Faktorët e shfaqjes së korrupsionit janë të shumtë dhe përfshijnë:

Mungesën e transparencës: Proceset shtetërore ku mungon transparenca hapin rrugën për korrupsion duke e lejuar atë që të zhvillohet lehtë pa u zbuluar.

Pushteti i paligjshëm: Zbatimi i pushtetit dhe autoritetit në mënyrë të paligjshme për përfitime personale është një faktor tjetër që promovon korrupsionin.

Mungesa e kontrollit dhe monitorimit: Në vendet ku korrupsioni lulëzon kontrolli dhe monitorimi nga ana e shtetit është shumë i vogël ose pothuajse nuk ekziston sepse kështu ju përshtatet pushtetarëve.

Kulturat dhe normat sociale: Kulturat që promovojnë ose tolerojnë praktikën e korrupsionit si dhe normat sociale që lejojnë veprime të tilla ndikojnë në paraqitjen e korrupsionit.

¹¹² Shih “Programi kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Evropën Juglindore”, Këshilli i Evropës, Prishtinë 2002, fq. 4.

¹¹³ Poda, Z. “Krimi i organizuar transaksional, sistem dhune dhe pushteti”, Tiranë, 2007, fq. 36.

¹¹⁴ Hysi, V. Kriminologjia, Tiranë, 2012, fq. 56.

¹¹⁵ Gjonca, L. Korrupsioni (Veprat penale përbërëse, krimi i organizuar), Tiranë, 2004, fq. 228.

Pabarazitë sociale dhe ekonomike: Në vendet ku pabarazitë sociale janë më të mëdha edhe niveli i korrupsionit është më i madh sepse atyre që kanë më shumë pasuri ju jepet më shumë fuqi dhe autoritet.¹¹⁶

Faktorët objektiv të paraqitjes së korrupsionit janë ata që janë më tepër të jashtëm dhe që ndikojnë më shumë në mjedisin ku korrupsioni zhvillohet.

Disa nga *faktorët objektiv* kryesorë janë:¹¹⁷

1. Mungesa e kontrollit institucional
2. Mungesa e legjislacionit
3. Mungesa e llogaridhënies
4. Pushteti i koncentruar
5. Kushtet ekonomike të vështira
6. Mungesa e ndërgjegjësimit
7. Mungesa e sanksioneve efektive
8. Korrupsioni në nivel ndërkombëtar

Faktorët subjektiv të paraqitjes së korrupsionit janë ata që kanë të bëjnë me karakteristikat dhe sjelljet e individëve që përfshihen në veprime korruptive.

Disa nga *faktorët subjektivë* kryesorë janë:¹¹⁸

1. Përfitimi personal
2. Gjendja morale dhe etike
3. Presioni social
4. Papërgjegjësia personale

4.3 Pasojat e korrupsionit

Korrupsioni e shtrembëron realitetin politik, duke i sjellë shkatërrim sistemit elektoral, administrativ, institucional e të gjithë mekanizmave që mbajnë një shtet në lëvizje. Këto mekanizma janë shpesh shtetëror, të pavarur, mediatik por edhe civilë. Korrupsioni kërcënon demokracinë, qeverisjen dhe shtetin ligjor duke ndryshuar procese legjitime dhe formale brenda shtetit. Korrupsioni ndikon në zgjedhje, në shtet ligjor dhe në përgjegjësinë e administratës për të shërbyer në mënyrë sa më korrekte dhe për të mos abuzuar me ligjet e shtetit.

Pasojat e korrupsionit në efektet ekonomike dhe sociale në shtresat e ndryshme shoqërore, janë shumë serioze për çdo shoqëri. Pështja e pasojave të korrupsionit në çdo shoqëri varet nga shumë faktorë. Madje, pasojat e korrupsionit varen edhe nga lloji i korrupsionit që dominon në

¹¹⁶ Josiane Fahed- Sreih, “Corruption- New insights”, 2023, fq. 84

¹¹⁷ Po aty, fq. 85.

¹¹⁸ Po aty, fq. 86.

shtetin përkatës. Korrupsioni jep varfëri dhe rënie të përgjithshme ekonomike të shoqëruar me pakënaqësi shoqërore ndaj reformave për zhvillimet demokratike, sjell uljen e efektivitetit të funksionimit të pushtetit shtetëror dhe zvogëlimin e besimit të qytetarëve te organet e shërbimit publik shtetëror.¹¹⁹

Korrupsioni dëmton rëndë zhvillimin ekonomik të një vendi. Efektet e tij janë negative edhe në zhvillimin e ekonomisë dhe të mekanizmave të tregut. Praktikët korruptive e veçanërisht vonesat e justifikuara, zvarritjet burokratike apo privilegjet e padrejta, kanë ndikuar që konkurrenca të mos ketë zhvillim të lirë dhe operatorët ekonomikë të mos kenë mundësi për gara të barabarta.¹²⁰

Korrupsioni e ngulfat konkurrencën e lirë, në mënyrë të veçantë kompanitë e vogla, ku me rënien e konkurrencës, ulët edhe cilësia e shërbimeve dhe mallrave. Ulen të ardhurat shtetërore dhe rritet ekonomia joformale. Aty ku tolerohet korrupsioni, punëtorët civilë marrin të ardhura të vogla dhe mbi qytetarët e thjeshtë rëndon mito që ata duhet të paguajnë për zgjidhjen e problemeve të tyre.¹²¹

4.4 Zbulimi dhe hetimi i korrupsionit

Sipas Dr. Begeja përpunimi kriminalistik dhe ndjekja penale për korrupsion fillon me kallëzimin e personit të ngarkuar me funksion shtetëror lidhur me kallëzimin e shtetasve, nga ushtrimi i kontrollit të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, nga njoftimet anonime, nga të dhënat e shtypit etj.¹²²

Detyra themelore në studimin e këtyre materialeve është përcaktimi nëse veprimet ose mosveprimet e personave të ngarkuar, për të cilët bëhet fjalë në kallëzim, kanë elementet e figurës së krimit të shpërdorimit të detyrës. Detyrë tjetër në studimin e këtyre materialeve është edhe verifikimi i saktësisë së dhënave. Sipas këtij shkencëtari, veprimet e para hetimore dhe veprimet e tjera mund të jenë ekspertimi kriminalistik, ekonomik, teknologjik etj, pyetja e personit, veprimet e të cilit verifikohen, njohja me strukturën dhe karakterin e veprimtarisë së ndërmarrjes ose institucionit ku ka ndodhur krimi etj. Verifikimi bëhet me anë të disa veprimeve hetimore, pyetja e dëshmitarëve, ballafaqimi etj.¹²³

Në procesin e hetimit të krimit të shpërdorimit të detyrës zyrtare zbulohen shkaqet dhe rrethanat që ndikuan në kryerjen e tyre. Krimet në ushtrimin e detyrës kryhen në qendrën e punës. Për këtë

¹¹⁹ Gjonça, L. Korrupsioni (Veprat penale përbërëse, krimi i organizuar), Tiranë, 2004, fq. 301.

¹²⁰ Johnson S, Kaufmann D & Zoido-Lobaton P, “Korrupsioni, financat publike dhe ekonomia jozyrtare”, fq. 72

¹²¹ Po aty, fq. 74.

¹²² Begeja, S. Kriminalistika, Tiranë, 2004, fq. 588-599.

¹²³ Po aty, fq. 600.

arsye qdo veprim ose mosveprim bjen në sy të puntorëve të ndërmarrjes. Këta mund të japin të dhëna për shpërdorimet e ndryshme të personave në detyrë, se ku mund të ndodhen dokumentet që i interesojnë organit të procedurës, sqarojnë rrethanat që kanë të bëjnë me veprimet ose mosveprimet e paligjshme të personave në detyrë dhe me personalitetin e të pandehurit.¹²⁴

Çelësi i reduktimit të korrupsionit qëndron në bërjen e njerëzve më pak të varur nga ai. Mekanizmi kryesor për t'i bërë njerëzit më pak të varur nga udhëheqësit e korruptuar është një regjim universal i mirëqenies sociale dhe veçanërisht i bazuar në sistemin e arsimit për të gjithë, përfshirë bërjen e universitetit në dispozicion për të gjithë qytetarët, diçka që është ndërkohë e vendosur në Suedi.¹²⁵

4.5 Parashkrimi i veprave penale të korrupsionit

Një nga shqetësimet më kryesore të sistemit kosovar të drejtësisë që disa vite është parashkrimi i lëndëve dhe mjaft shqetësuese ka qenë dhe është edhe parashkrimi i lëndëve të korrupsionit.

Parashkrimi konsiston në arritjen e afatit të caktuar ligjor, pas të cilit afat institucionet e humbin të drejtën për ndjekjen penale apo shqiptimin e dënimit. Sipas nenit 99 të KPRK në rastet kur arrin afati i parashkrimit, ndjekja penale nuk mund të fillohet.¹²⁶

Për parashkrimin e ndjekjes penale, institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të kujdesen sipas detyrës zyrtare. Kështu, pa marrë parasysh ekzistimin e kërkesës së të pandehurit, në secilin rast kur ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale, institucionet nuk duhet ta fillojnë ndjekjen penale, respektivisht duhet ta pushojnë ndjekjen penale.¹²⁷

Kodi Penal i ka përcaktuar afatet e parashkrimit, varësisht dënimit të përcaktuar me ligj. Janë dy lloje të afateve të parashkrimit: absolut dhe relativ. Me parashkrim relativ nënkuptojmë vonesën e institucioneve të sistemit të drejtësisë për të ndërmarrë veprimet e caktuara procedurale ku për të cilat arsye parashkruhet ndjekja penale. Ndërsa, me parashkrim absolut nënkuptojmë kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale deri në momentin kur vepra penale parashkruhet

Afati i parashkrimit absolut është më i gjatë sesa ai relativ. KPRK ka përcaktuar afatet e parashkrimit relativ, derisa afati i parashkrimit absolut është dyfishi i afatit të parashkrimit relativ.

¹²⁴ Latifi, Vesel, Kriminialistika, Prishtinë, 2011, fq. 280.

¹²⁵ Uslaner, E “Corruption, Inequality and the Rule of Law”, Cambridge, 2008, fq. 247.

¹²⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074, neni 99, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 18.09.2024.

¹²⁷ Salihu I. Zhitija H. dhe Hasani F. “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës”. Botimi 1. Prishtinë, 2014, fq. 329-330.

Sipas nenit 100 par.1 të KPRK afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës penale shfaqet më vonë, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga ajo kohë.¹²⁸

Duke u nisur nga fakti se arritja e afatit të parashkrimit nënkupton pamundësinë e institucioneve të sistemit të drejtësisë për të zhvilluar procedurën penale, kjo i bie se në secilin rast kur arrin ky afat, veprat penale mbesin pa u gjykuar në mënyrë meritore. Kështu, në njëfarë mënyre parashkrimi i amnistion kryerësit e veprave penale. Por, ky afat dëmton edhe personat e akuzuar padrejtësisht, mbi pafajësinë e të cilëve gjykata nuk mund të vendos në mënyrë meritore. Për këto arsye, kërkohet nga institucionet e sistemit të drejtësisë që të veprojnë në mënyrë efikase, në mënyrë që të ulët numri i rasteve të parashkruara.

Arsyeja kryesore e parashkrimit të rasteve të korrupsionit është mos procedimi i lëndëve gjyqësore brenda afateve kohore që janë përcaktuar me ligj. Me qëllim të garantimit të gjykimit brenda afateve të arsyeshme kohore, i cili gjykim në parim pamundëson parashkrimin e lëndëve, KPPK ka përcaktuar afatet kohore të hetimit dhe gjykimit.

Edhe kthimi i shpeshtë i rasteve në rigjykim është një prej arsyeve që krijon vonesa të konsiderueshme në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe si rrjedhojë edhe ky faktor ndikon konsiderueshëm në arritjen e afatit të parashkrimit. Ndryshimi i përbërjes së trupeve gjyqësore është një prej arsyeve të tjera që zvarritjen e lëndëve gjyqësore. Në këto raste, sipas nenit 307 par.1 të KPRK kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, përveç rasteve që mund të korrigjohen sipas nenit 284 të këtij Kodi, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit.¹²⁹

Sipas një publikimi të Institutit për Drejtësi të Kosovës vetëm gjatë vitit 2022 janë parashkruar rastet ndaj 28 të pandehurve të akuzuar për korrupsion. Këta 28 persona bëjnë pjesë në gjithsej 16 raste.¹³⁰

Dëmi sipas prokurorisë në këto raste fillon nga 5 euro deri në 5.4 milion euro. Nëse kalkulohet dëmi i pretenduar nga Prokuroria në këto raste, i bie se vetëm brenda vitit 2022 janë parashkruar rastet e korrupsionit, dëmi në të cilat kalon vlerën prej 6 milion eurove. Madje, kjo vlerë llogaritet të jetë vetëm për 11 raste të korrupsionit, pasi në pesë raste të tjera, prokuroria nuk e ka përcaktuar dëmin në aktakuzë.¹³¹

¹²⁸ Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074, neni 100 par.1, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 26.09.2024.

¹²⁹ Po aty, neni 307 par.1.

¹³⁰ Raport i korrupsionit, i qasshëm në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/IKD-Raporti-i-Korrupsionit-2022-Deshtimi-i-drejtësisë-ne-luftimin-e-korrupsionit-15.04.2023-2-1.pdf>, shfletuar më 29.07.2024.

¹³¹ Raport i parashkrimit të korrupsionit, i qasshëm në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/Final-Raporti-Parashkrimi-i-korrupsionit-2022.pdf>, shfletuar më 29.07.2024.

KAPITULLI V

Korrupsioni në Gjilan gjatë periudhës 2018-2023

Vepra penale e korrupsionit siq është trajtuar edhe në kapitujt me lartë është e shfaqur kudo në Kosovë e njëjtë edhe në Gjilan.

Edhe pse pothuajse çdo ditë lexojmë lajme të ndryshme për korrupsionin e llojeve të ndryshme që kryhet nga gjykatësit, mjekët, referët e edhe nga nëpunësit më të thjeshtë shtetërorë, rastet kur për veprën penale të korrupsionit bëhet kallëzim penal ose ngritet aktakuza janë më të rralla. Për arsye të mos trajtimit me kohë të veprave penale të korrupsionit, shumë vepra janë parashkruar dhe në këtë mënyrë kanë përfunduar pa u marrë një vendim meritator mbi fajësinë e kryerësve të tyre. Gjithashtu, shumë raste të korrupsionit kanë dështuar edhe për faktin se provat kryesore me të cilat prokuroria ka synuar t'i provoj pretendimet e saj, janë shpallur të papranueshme. Po ashtu, problem i trajtimit të rasteve të korrupsionit, është edhe zvarritja e madhe e lëndëve, që përpos mos respektimit të të drejtave të të pandehurve për gjykim në kohë të arsyeshme ndikon edhe në rritjen e dëmit ndaj buxhetit të shtetit.

Për mos zbulimin e veprës penale të korrupsionit ka faktorë të ndryshëm p.sh ato më së shpeshti mbulohen apo fshehën me:

- Me kontrata fiktive mbi vepër
- Me lidhjen fiktive të marrëdhënjëve të punës
- Me lejin e provizioneve joreale
- Lëshimin e letrave garantuese

- Me angazhimin e personave të caktuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm, këshilltarëve etj.¹³²

Korrupsioni në prokurimin publik, apo siç njihet ndryshe “korrupsioni me tender”, nga shpallja e pavarësisë e tutje ka qenë një nga format më të shpeshta përmes të cilave zyrtarët e shtetit kanë ardhur shpejtë te pasurimi i kundërligjshëm dhe i shpejtë.

Qytetarët e komunës së Gjilanit kanë qenë shpeshherë të përfshirë në afera korruptive, ndër rastet më të famshme të korrupsionit në këtë qytet padyshim se janë rasti i ish Kryetarit të Komunës Q.M, i cili së bashku me 38 të pandehur kanë qenë të akuzuar nga PSRK-ja për kurdishjen e tenderëve.

Sipas aktakuzës, zyrtarët kanë vepruar në cilësinë e personave zyrtarë, kanë keqpërdorë detyrën zyrtare, duke i tejkaluar kompetencat e tyre apo duke mos i përmbushur detyrat e tyre zyrtare. Ndërsa, të pandehurit e tjerë duke vepruar si pronarë apo përfaqësues të këtyre operatorëve ekonomik kanë ushtruar veprimtari ekonomike me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për operatorin ekonomik tjetër, me rastin e ofertimit në aktivitete të prokurimit, pranë asaj komune.¹³³

Për këtë rast nga viti 2019 e tutje sistemit të drejtësisë i është dashur shumë angazhim për shkak se ky rast ka kaluar një fazë të gjatë të procesit të konfirmimit të aktakuzës. Pas konfirmimit të aktakuzës dhe pas 23 seancave të caktuara, 12 nga të cilat në vitin 2021, shkalla e parë ka vendosur t’i liroj të gjithë të akuzuarit, për shkak se provat kryesore të këtij rasti e që ishin përgjimet që i inkriminonin të akuzuarit, është konsideruar nga gjykata se janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo për faktin se në shkresat e lëndës ka munguar kërkesa e prokurorisë për lëshimin e urdhërësës për masat e fshehta të përgjimit, e cila kërkesë nuk gjendej as nga ana e Prokurorisë. Por anomalia më e madhe është edhe fakti se si Ish-Gjykata e Qarkut të Gjilanit, ka lëshuar urdhërësë për përgjime pa kërkesë të prokurorisë. Në këtë mënyrë, pyetja legjitime të cilës nuk i është dhënë përgjigje është nëse nuk ka ekzistuar fare një kërkesë e tillë apo e njëjta është zhdukur gjatë zhvillimit të procedurës. Në anën tjetër, gjykata po ashtu ka konstatuar se në këtë rast në kundërshtim me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale urdhërësja është lëshuar në vitin 2012, por pa pasur dyshim të bazuar për të pandehurit, kurse hetimet kishin filluar në vitin 2015, e po ashtu se masat e përgjimit janë lëshuar vetëm ndaj tre personave, kurse janë përgjuar edhe 36 persona të tjerë. Në këtë mënyrë, përderisa prova kryesore në këtë rast është konstatuar se është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, i bie se një vendim i tillë do të mund të merrej në fazën e konfirmimit të aktakuzës dhe nëse do të ndodhte kjo, aktakuza mund të rrëzohej pa u zhvilluar fare shqyrtimi maratonik gjyqësor.

Pas vazhdimit të procesit gjyqësor për disa vite, në fund të gjithë të akuzuarit janë liruar nga aktakuza.

¹³² Veseli L, Kriminalistika, 2011, fq.273.

¹³³ Raport i Betimit për Drejtësi, i qasshëm në: <https://betimiperdrejtesi.com/qemajl-mustafa-dhe-te-akuzuarit-tjere-lirohen-nga-akuzat-per-korrupsion-me-tendere-dhe-krim-te-organizuar/>, shfletuar më 24.08.2024.

Rast tjetër që kishte bërë bujë ishte edhe rasti i drejtorit të departamentit të prokurimit në Gjiilan S.K. i cili ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, lidhur me kontratën kornizë “Mirëmbajtja e ndriçimit publik në fshatrat e komunës së Gjiilanit”, e lidhur në mes të Komunës së Gjiilanit dhe kompanisë “Elektring” nga Ferizaji, e cila kontratë ka qenë trevjeçare.¹³⁴

Në fund edhe ky rast ka përfunduar me aktgjykim lirues.

Gjatë hulumtimit të bërë në arkivat e Gjykatës Themelore në Gjiilan dhe Prokurorisë Themelore në Gjiilan për periudhën kohore 2018-2023 del në pah se vetëm për një numër të vogël të veprave penale të korrupsionit është ngritur aktakuzë dhe shumica e aktgjykimeve kanë qenë liruese.

Në tabelën e mëposhtme janë të shfaqura veprat penale që janë gjykuar në Gjykatën Themelore në Gjiilan.

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik (neni 415)	12	8	6	6	7	18
Përvetësimi në detyrë (neni 418)	0	1	0	0	1	0
Mashtrimi në detyrë (neni 419)	0	0	1	0	0	0
Marrja e ryshfetit (neni 421)	2	2	1	2	0	0
Ushtrimi i ndikimit (neni 424)	0	0	0	1	0	0
Falsikimi i dokumentit zyrtar(neni 427)	1	1	0	0	1	0

Tabela 1. Veprat penale të korrupsionit në Gjykatën Themelore në Gjiilan

Si vepër penale e korrupsionit më e përhapura është vepra penale e keqpërdorimit dhe mashtrimit në prokurim publik. Shqetësues është fakti se shumica e aktgjykimeve janë të karakterit lirues ose dënime me gjobë, gjë e cila ndikon në uljen e besimit të qytetarëve tek sistemi gjyqësor.

¹³⁴ Raport nga Kallxo, i qasshëm në: <https://kallxo.com/ligji/salih-kqiku-i-akuzuar-per-keqperdorim-te-detyres-ne-zyren-e-prokurimit-ne-gjilan-para-gjyqit-te-apelit/>, shfletuar më 24.0.2024.

Në figurat e mëposhtme do të shikohen se cilat lloje të dënimeve janë shqiptuar për kryesit e veprës penale të korrupsionit dhe sa ka qenë vlera e dënimeve me gjobë.




Figura 1. Llojet e sanksioneve penale të shqiptuara




Figura 2. Vlera e dënimeve me gjobë

Përfundime

Praktika tregon se edhe vendet më të zhvilluara në botë me organet gjyqësore më efektive, kanë humbur shumë beteja në përballje me korrupsionin. Kjo ndodh sepse kjo dukuri negative ka prirje që të rritet më shpejtë sesa dinamikat e implementuara për larguar atë. Ai është i llojlojshëm dhe shërbimet e tij paguhen në të gjitha forma të ndryshme si në para, me kundërshtpërblim, në rrafsh tjetër, me dhurata-ryshfete etj.

Korrupsioni ndodh në shtetet dhe vendet në zhvillim si dhe është karakteristikë e atyre vendeve që sapo kanë hedhur pas sistemin totalitar. Skandalet e korrupsionit nuk janë të pranishme vetëm në vendet në zhvillim ku korrupsioni shpesh shihet si një taksë, por ai është prezent edhe në vendet e zhvilluara si Britania e Madhe, Franca dhe SHBA-të.

Korrupsioni sot është një dukuri negative që është prezente në çdo shoqëri pa përjashtim, por në një nivel shumë më të lartë në vendet më pak të zhvilluara, ku korrupsioni paraqet sfidën kryesore. Shtetet e Ballkanit radhiten kah mesi i listës botërore së shteteve sa i përket korrupsionit.

Korniza ligjore kundër korrupsionit në Kosovë është e pranishme por prapë mbetet një sfidë parandalimi dhe zbatimi efektiv i saj.

Zvogëlimi i nivelit të korrupsionit është një proces i vështirë dhe i ngadalshëm sepse lidhet me faktorë të ndryshëm historikë, ekonomikë dhe politikë të cilët veprojnë në shkallë dhe forma të ndryshme.

Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit është një detyrë e përcaktuar me ligj që rregullon deklarimin e pasurisë, konfliktin e interesit dhe fushat e tjera që lidhen me veprimtarinë e institucioneve të zbatimit të ligjit, por njëkohësisht është edhe obligim i cili rrjedh nga anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit, siç janë Konventa Penale kundër Korrupsionit e Këshillit të Europës, Konventat e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit dhe standarde të tjera kundër korrupsionit.

Përkundër përparimit të arritur deri më tani, Kosova sikurse vendet e tjera në rajon, vazhdon të përballlet me vështirësi në sektorin e sundimit të ligjit, me mangësi në sistemin gjyqësor, çështjet e brendshme dhe qasjen në drejtësi sepse edhe nga raportet e ndryshme ndërkombëtare shihet nevoja për angazhim të shtetit në përmirësimin e efikasitetit të prokurorisë, gjyqësorit dhe policisë në përgjithësi e në veçanti parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Kosova ka legjislacion në fushën e parandalimit, luftimit dhe hetimit të korrupsionit, poashtu ka themeluar institucione me mandat që lidhen me fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, në mbrojtjen e sinjalizuesve, kufizimet lidhur me pranimin e dhuratave që ndërlidhen me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e

pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërta me ta dhe kufizimet lidhur me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Si probleme kryesore të korrupsionit janë:

Mungesa e legjislacionit adekuat për financim të partive politike, për monitorim dhe auditim të financave të tyre;

Problemi i nepotizmit, politizimit në pranimin e nepunësve në administratën publike, konfliktit të interesit;

Keq menaxhimi i shpenzimeve të të hyrave të institucioneve publike dhe mungesa e auditimit të brendshëm;

Mosforcimi i mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interes dhe mungesa e gjobave;

Për të luftuar korrupsionin, një nga strategjitë më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe përmirësuar vazhdimisht është që korrupsioni të shndërrohet në nocion që nuk sjell leverdi, ku njerëzve të korruptuar iu merren fitimet që rrjedhin nga vepra penale e korrupsionit në mënyrë që të eliminohen veprimet që sjellin pushtet dhe pasuri të mëdha nëpërmjet praktikave korruptive.

Rekomandime

Kosova duhet të punojë për ndërtimin e një strategjie serioze, të mirëfilltë dhe efikase në luftën kundër korrupsionit.

Edhe pse legjislacioni kundër korrupsionit ekziston, rezultatet në praktikë lënë shumë për të dëshiruar sepse korrupsionin e kemi prezent pothuajse në secilin vend dhe besimi i qytetarëve tek institucionet shtetërore është mjaft i vogël, por megjithatë duhet bërë përpjekje.

Si përpjekje duhet të jenë:

1. Përmirësimi i kornizës institucionale kundër korrupsionit

Përmirësimi i kornizës institucionale kundër korrupsionit, duhet të fokusohet në ndërtimin e një kornize të qëndrueshme institucionale dhe legjislative e cila është e pajisur me të gjitha mjetet e duhura për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Duke qenë se skema aktuale kundër korrupsionit është e ndërlikuar, me shumë institucione të përfshira në mënyrë direkte ose indirekte në të, qartësimi i rolit dhe përgjegjësisë të secilit organ kompetent për luftimin e korrupsionit është njëra ndër masat kryesore që ofron kjo objektivë. Me qëllim të luftimit të suksesshëm të korrupsionit duhet edhe bashkëpunimi me akterët jo shtetëror të përfshirë në luftimin e korrupsionit.

2. Ngritja e llogaridhënies së sistemit gjyqësor dhe prokurorial

Kjo objektive duhet fokusuar në rritjen e përgjegjësisë së sistemit gjyqësor dhe prokurorial si brenda edhe jashtë sistemit. Një sistem llogaridhënës është garantues për përgjegjësinë individuale të profesionistëve brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përmes garantimit të transparencës në punë dhe mekanizmave kualitativë të avancimit dhe disiplinimit eventual të tyre. Ky sistem llogaridhënës është garantues për mbrojtjen dhe lirinë e prokurorëve dhe gjyqtarëve në kryerjen e detyrave të tyre. Duhet të ndërtohet një sistem i përmirësuar i kontrolleve dhe balanceve, të rritet transparenca për punën e KPK-së, KGJK-së, vlerësime të bazuara dhe transparente të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, proces i avancimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve i bazuar në merita etj.,

3. Ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial

Ngritjen e efikasitetit synon që të rrisë shpejtësinë dhe të përmirësojë mbarëvajtjen e zgjidhjes së lëndëve nga gjykatat, si dhe ndjekjen e tyre në mënyrë efektive nga prokuroria. Përveç shpejtësisë, përmes kësaj objektive shënjestrohen lëndët e grumbulluara në gjykata, fenomeni i shtyerjes së seancave gjyqësore dhe shkalla e ulët e përdorimit të mjeteve alternative për zgjidhje të mosmarrëveshjeve. Në mënyrë që të rritet efikasiteti i gjithë sektorit të sundimit të ligjit duhet bërë përpjekje në digjitalizimin dhe përdorimin e teknologjisë moderne nëpër sektor.

4. Rritja e integritetit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Këtu duhet synuar ndërtimi i një sistemi gjyqësor dhe prokurorial të përbërë nga profesionistë me integritet të lartë moral dhe profesional, të cilët avancohen përmes një sistemi të bazuar në merita dhe të cilët dëshmojnë këtë integritet gjatë shërbimit të tyre në detyrë.

5. Përmirësimi i sistemit të deklarimit të pasurisë dhe rregullave për pranimin e dhuratave në Kosovë

Synimi për përmirësimin e sistemit të deklarimit të pasurisë dhe rregullave për pranimin e dhuratave, ka për qëllim krijimin e një sistemi i cili promovon një kulturë të llogaridhënies dhe integritetit, inkurajon sjellje etike dhe rrit besimin e qytetarëve në sektorin publik. Një sistem i qëndrueshëm dhe efektiv i deklarimit të pasurisë dhe pranimit të dhuratave, do të shërbente edhe si burim i sigurtë i informacionit për hetimin e pasurimit të paligjshëm dhe luftimin e korrupsionit në përgjithësi.

Bibliografia

Libra dhe artikuj:

Adela SHERA, ‘‘Korrupsioni dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike’’, Tiranë, 2014.

Azem R. Hajdari, ‘‘Veprat penale me natyrë korrupsioni me një vështrim të posaçëm në Kosovë’’, Prishtinë, 2003.

Antonić D, ‘‘Korupcija u Srbiji’’, Beograd, 2001.

Duk V. Trang, ‘‘Korrupsion dhe demokraci’’, Institucionet, Proceset dhe Korrupsioni Politik në vendet në tranzicion të Evropës Qendrore dhe në ish-Bashkimin Sovjetik, Instituti për Politikën Kushtetuese dhe Legjislative, 1994, Tiranë.

Del Monte, A&Papagni E., ‘‘The Determinants of Corruption in Italy: Regional Panel Data Analysis’’, 2004.

David Torsello, ‘‘Corruption in public administration’’, Vienna, 2016.

Eric M. Uslaner, ‘‘Corruption, Inequality and the Rule of Law’’, Cambridge, 2008.

Edward Glaeser, ‘‘Lessons from America’s Economic History’’, 2004.

Ragip Halili, ‘‘Kriminologjia’’ Prishtinë, 2005.

Ismet Salihu, ‘‘E drejta penale-pjesa e përgjithshme’’, Prishtinë, 2015.

Ismet Salihu, Hilmi Zhitija dhe Fejzullah Hasani, ‘‘Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës’’, Prishtinë, 2014.

Jeff Huther, ‘‘Anti-corruption policies and programs: A framework for Evaluation’’, 2000.

Josiane Fahed- Sreih, ‘‘Corruption- New insights’’, 2023.

Luan Gjonça, ‘‘Korrupsioni, Veprat penale përbërësë, Krimi i organizuar’’, Tiranë, 2004.

Mihail Aurelian Bratu, ‘‘The Phenomenology of Corruption’’, 2015.

Marija Zurnic, ‘‘Corruption and democratic transition in Eastern Europe’’, Belgrade, 2019.

Mason Gaffney&Fred Harrison, ‘‘The corruption of economics’’, London, 2023.

Mbretëria e Bashkuar, Përgjigja e Qeverisë ndaj Përfundimeve dhe Rekomandimeve të Raportit të Komitetit të Përbashkët mbi Projektligjin për Korrupsionit, 2009.

Nebojsa Teofilovic, Milenko Jelacic Beograd, ‘‘Prevention, Detection and Proving corruption-related criminal acts and money laundering’’, 2006 .

Paolo Mauro, "Corruption and Economic Growth." Quarterly Journal of Economics, 1995.

Routledge Heidenheimer Arnold J, Michael Johnston, & Victor T. LeVine, "Corruption, Capitalism and Democracy", London, 1997.

Skender Begeja, "Kriminalistika", Tiranë, 2004.

Susan Rose-Ackerman, "Corruption and Government: Causes, Consequences and Reform".

Simon Johnson, Daniel Kaufmann & Pablo Zoido-Lobaton, "Korrupsioni, financat publike dhe ekonomia jozyrtare", 1999.

Vesel Latifi, "Zbulimi dhe luftimi i Korrupsionit", Prishtinë, 2007.

Vesel Latifi, "Kriminalistika", Prishtinë, 2011.

Vasilika Hysi, "Kriminologjia", Tiranë 2010.

Vermeulen G. dhe të tjerë, "Përgjegjësia e Personave Juridike për Vepra Penale në BE", 2012.

Vito Tanzi, "Korrupsioni në mbarë botën, shkaqet, pasojat, qëllimi, trajtimi", 1998.

Werlin, H, "The consequences of corruption: The Ghanaian experience", Political Science Quarterly.

Zamir Poda, "Krimi i organizuar transaksional, sistem dhune dhe pushteti", Tiranë, 2007.

Akte juridike:

Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e qasshme në: https://www.senate.gov/about/origins-foundations/senate-and-constitution/constitution.htm#a4_sec1.

Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, datë 14.01.2019, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>, shfletuar më 24.06.2023.

Kodi i përkohshëm Penal i Kosovës, datë 6.07.2003, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8674>, shfletuar më 07.09.2024.

Ligji për përgjegjësinë e personave juridike Nr.04/L-03-03, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2766>, shfletuar më 21.07.2023.

Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, ndryshuar me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013, ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, i qasshëm në: <https://qbz.gov.al/share/YCvI02dROybrYpg2hNERg>, shfletuar më 03.07.2024.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr.37/96, i qasshëm në: <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BD-%D1%82%D0%B5%D0%BA%D1%81%D1%82.pdf>, shfletuar më 14.06.2024.

Ligji Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60591>, shfletuar më 16.06.2024.

Ligji kundër korrupsionit nr. 2004/34 neni 2, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2441&langid=1>, shfletuar më: 08.07.2024.

Ligji Nr.2004/34 kundër korrupsionit, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2441>, shfletuar më 09.03.2024.

Konventa për korrupsionin e së drejtës penale të Këshillit të Europës e vitit 1991, e qasshme në <https://rm.coe.int/168007f3f5>, shfletuar më 24.06.2024.

Burime nga interneti:

Artikull i Transparency International, i qasshëm në: https://www.transparency.org/en/cpi/2023?gad_source=1&gclid=EAIaIQobChMI2Ojxs9XfhQM V9WWRBR2ZlQ_xEAAYASAAEgLDW_D_BwE, shfletuar më 07.05.2024.

Artikull i Komisionit Europian, i qasshëm në: https://home-affairs.ec.europa.eu/policies/internal-security/corruption_en, shfletuar më 09.05.2024.

Fjalor i Oxford-it, i qasshëm në: <https://www.oed.com/search/dictionary/?scope=Entries&q=corruption>, shfletuar më 10.04.2024.

Burim Ademi&Afrim Shala&Avni Mehmeti, “Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale)”, i qasshëm në: <http://jus.igjk.rks-gov.net/801/1/Moduli-penale-shqip%20i%20rishikuar%20nga%20autor%C3%ABt%20%28finali%29.docx.pdf>, shfletuar më 10.09.2023.

Strategjia për sundimin e ligjit 2021-2026, e qasshme në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Strategjia-per-Sundimin-e-Ligjit.pdf>, shfletuar më 22.08.2023.

Raport i Transparency International, i qasshëm në: <https://www.transparency.org/en/countries/albania>, shfletuar më 02.07.2024.

Raport i Transparency International, i qasshëm në: <https://www.transparency.org/en/news/cpi-2023-eastern-europe-central-asia-autocracy-weak-justice-systems-widespread-enabling-corruption>, shfletuar më 02.07.2024.

Artikull i qasshëm në: <https://ndiqparate.al/?p=19939>, shfletuar më 21.06.2024.

Raport i Transparency International, i qasshëm në: <https://www.transparency.org/en/countries/north-macedonia>, shfletuar më 17.06.2024.

Raport i korrupsionit, i qasshëm në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/IKD-Raporti-i-Korrupsionit-2022-Deshtimi-i-drejtësisë-ne-luftimin-e-korrupsionit-15.04.2023-2-1.pdf>, shfletuar më 29.07.2024.

Raport i parashkrimit të korrupsionit, i qasshëm në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/Final-Raporti-Parashkrimi-i-korrupsionit-2022.pdf>, shfletuar më 29.07.2024.

Raport i Betimit për Drejtësi, i qasshëm në: <https://betimiperdrejtesi.com/qemajl-mustafa-dhe-te-akuzuarit-tjere-lirohen-nga-akuzat-per-korrupsion-me-tendere-dhe-krim-te-organizuar/>, shfletuar më 24.08.2024.

Raport nga Kallxo, i qasshëm në: <https://kallxo.com/ligji/salih-kqiku-i-akuzuar-per-keqperdorim-te-detyres-ne-zyren-e-prokurimit-ne-gjilan-para-gjyqit-te-apelit/>, shfletuar më 24.0.2024.